



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI Nr: 1

NR I VENDIMIT:
DATA E VENDIMIT:

KPCC/D/A/149/2012
19/04/2012

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

- (1) Në secilën prej njëqind e pesëdhjetë e katër (154) kërkesave të identifikuara në pjesët A dhe C të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë;
- (2) Në secilën prej shtatëdhjetë e shtatë (77) kërkesave të identifikuara në pjesët B dhe D të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të refuzohet; dhe
- (3) Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse në pjesët B dhe D të listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisioni i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079)¹.

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksset

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e tetë nga 17 deri 19 prill 2012 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 2 135 kërkesa për pronë bujqësore në seancën e njëzetë e tetë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Tri kërkesa për pronë bujqësore të cilat iu paraqitën Komisionit u tërhoqën gjatë seancës nga Sekretaria Ekzekutive. Një kërkesë për pronë bujqësore i është kthyer Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni për përpunim të mëtejme. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e gjashtë kërkesave bujqësore në pritje të mbajtjes së seancës dëgjimore. Përveç kësaj, Komisioni vendosi 25 kërkesa të cilat ishin ndërprerë më herët në pritje të seancës dëgjimore. Gjithsej 2150 kërkesa për pronë bujqësore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat të përfshira në këtë vendim.

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim zbatohet për gjithsej 231 kërkesat e identifikuar në listën e bashkangjitur. Pjesa e mbetur prej 1,919 kërkesash për pronë bujqësore të trajtuara nga Komisioni gjatë seancës përfshihen në dy vendimet e tjera, pikërisht vendimet KPCC/D/A/147/2012 dhe KPCC/D/A/148/2012.

9. Gjithsej 219 kërkesa të përfshira në këtë vendim nuk janë shqyrtuar më parë nga Komisioni, ndonëse dymbëdhjetë kërkesa të identifikuar në kolonën përkatëse të pjesës C të listës së bashkangjitur ishin subjekt i një vendimi të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimi i mëparshëm për këto kërkesa është shfuqizuar nga Komisioni për shkak të notifikimit të pasaktë të pronës së kërkuar gjatë përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive ose gabimeve të tjera të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë identifikuar pasi është marrë vendimi. Për rrjedhojë, këto kërkesa duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar. Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar paraqitësit të kërkesës duke e informuar atë për gabimet e notifikimit dhe i ka informuar se kërkesa do të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës të kërkuar. Paraqitësi i kërkesës si dhe autoritetet kadastrale përkatëse janë informuar se vendimi i mëparshëm i Komisionit është pavlerë dhe nuk mund të përdoret për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor.

10. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të

e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksin e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksin e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislativë dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksin I, II dhe III, respektivisht.

drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

11. Komisioni vëren se 96 kërkesat e shënuara në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose pala që ka shprehur interes ligjor në këto prona ("pala përgjegjëse") e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, secilës prej palëve përgjegjëse i është dorëzuar një kopje e kërkesës të parashtruar nga paraqitësi përkatës i kërkesës. Në bazë të nenit 3.5 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësve të kërkesave u është dorëzuar një kopje e dokumenteve të parashtruara nga palët respektive përgjegjëse në kërkesë. Të dy palëve, në secilën rast, u është dhënë mundësia të komentojnë për informacionin e ofruar nga pala tjetër, edhe komentet apo informacioni i tillë është marrë në konsideratë gjatë përpunimit dhe vendosjes të kërkesës.

12. Komisioni vëren se 135 kërkesat e shënuara në pjesën C dhe D të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sekretaria Ekzekutive ka notifikuar kërkesat në mënyra të ndryshme duke përfshirë notifikimin fizik të pronës, dhe/ose me anë të notifikimit të pronës përmes publikimit në gazeta zyrtare dhe gazeta, përmes autoriteteve vendore komunale, gjykatave vendore, udhëheqësve vendorë në fshat dhe institucioneve përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informacionet e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

B. Kërkesa të hedhura poshtë

13. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

14. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

15. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykatë vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit.)

16. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj për pronën e kërkuar.

17. Ndonëse Komisioni ka pikëpamjen se humbja e posedimit që ka ndodhur përtej periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 megjithatë mund të konsiderohet që ndërlidhet drejtpërsëdrejti me, apo që është pasojë e konfliktit, varësisht nga rrethanat e rastit, ai duhet të konstatojë se ka disa dëshmi që tregojnë se humbja e posedimit përfshin rrethanat që janë pasojë e konfliktit.

I Kërkesa kontestuese

1. Tjetërsimi vullnetar, aftësia për të ushtruar të drejtën pronësore.

a. Kërkesa nr. 06282

18. Kërkesa nr. 06282 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 43 e cila e tregon atë si bashkëpronar të pronës së kërkuar me motrën e tij. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 1987, por dokumentet ishin shkatërruar gjatë luftës. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive e gjeti *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. UL-72217090-00558, e cila e tregon pronën në emër të palës së tretë, Heset Ajeti, në bazë të një kontratë të blerjes nr 3587/07. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se ia kishte shitur pronën e kërkuar palës së tretë në vitin 2007. Paraqitësi i kërkesës ra dakord të tërheqë kërkesën, por dështoi ta bëjë këtë. Kështu, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

b. Kërkesa nr. 10310

19. Kërkesa nr. 10310 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një kontratë dhurimi VR. Nr. 1630/2004, në bazë të secilës, atij i ishte dhuruar $\frac{1}{4}$ e pjesës ideale të pronës së kërkuar dhe fletën poseduese nr. 23 që e tregon atë si pronar të një pjese të pronës së kërkuar. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar nga Paraqitësi i kërkesës duke mbetur kështu bashkëpronarë dhe ka dorëzuar kontratën e blerjes nr. 2278/2007 dhe një Certifikatë të përditësuar për Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 217 që e tregon palën përgjegjëse dhe Rrahman Ollurin si pronarët e pronës së kërkuar, e cila ishte e ndarë në dy parcela. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një deklaratë me shkrim të datës 5 shtator 2007 ku thuhej se ai dëshironte të tërheqë kërkesën pasi e kishte shitur atë në vitin 2007. Paraqitësi i kërkesës paraqiti gjithashtu një kopje të kontratës së blerjes. Ai u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive dhe iu kërkuar që të nënshkruajë një formular për tërheqjen në një nga zyrat e AKP-së, megjithatë, Paraqitësi i kërkesës ka dështuar ta bëjë këtë. Rrjedhimisht kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

c. Kërkesa nr. 13269

20. Kërkesa nr. 13269 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore, pikërisht bashkëshortes së tij. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar me tre bashkëpronarë dhe ka dorëzuar një kontratë blerje nr. 3325/06, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj më 7 gusht 2006 dhe një faturë pagese për 18,620 euro për tre parcelat e të tokës, e cila përfshin pronën e kërkuar, e nënshkruar nga bartësi i së drejtës pronësore dhe pala përgjegjëse. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, e cila e tregon pronën në emër të palës përgjegjëse dhe të bashkëpronarëve. Në fillim Paraqitësi i kërkesës deklaroi se bartësi i së drejtës pronësore ka qenë nën presion për shitjen e pronës së kërkuar tek pala përgjegjëse dhe se çmimi i plotë i blerjes nuk ishte paguar. Megjithatë, ajo më vonë paraqiti një deklaratë me shkrim përmes Zyrës për Çështje Pronësore të UNHCR-së ku ka konfirmuar se prona i ishte shitur palës përgjegjëse, por ndjehet e tradhtuar nga pala përgjegjëse, pasi ai kishte rënë dakord të blinte pronat e tjera në pronësi të mbajtësit të së drejtës pronësore dhe nuk i ishte përmbajtur marrëveshjes. Paraqitësi i kërkesës nuk e tërhoqi kërkesën. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

d. Kërkesat nr. 22485 dhe 22486

21. Kërkesat nr. 22485 dhe 22486 janë paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore. Pala përgjegjëse në kërkesën nr. 22485, i cili aktualisht ka uzurpuar pronën e kërkuar, pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar nga Paraqitësi i kërkesës në vitin 2007. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme për pronat e kërkuara, e cila i tregon të dy palët përgjegjëse si pronarët e pronave të kërkuara përkatëse. Më pas, paraqitësi i kërkesës konfirmoi shitjen e pronave të kërkuara tek dy palët përgjegjëse në vitin 2007, por nuk i tërhoqi kërkesat. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

e. *Kërkesat nr. 23029 dhe 23030*

22. Kërkesat nr. 23029 dhe 23030 janë paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një kontratë të përkujdesjes jetësore që tregon se atij i është dhënë pronësia për pronat e kërkuara pas vdekjes së babait të tij. Pala përgjegjëse pretendon se i ka blerë pronat e kërkuara nga babai i Paraqitësit të kërkesës nëpërmjet avokatit të tij, Sait Hyseni më 2 qershor 2003 dhe paraqiti një kontratë të vërtetuar blerje VR. Nr. 9272/2003, sipas së cilës, regjistrat kadastralë janë përditësuar në emër të palës përgjegjëse. Pala përgjegjëse paraqiti një kopje të fletës poseduese nr. 338, e cila i tregon pronat e kërkuara në emrin e tij. Gjatë përpunimit të kërkesës, paraqitësi i kërkesës paraqiti një deklaratë me shkrim më 17 nëntor 2011, duke pranuar se pronat e kërkuara i ishin shitur palës përgjegjëse. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

f. *Kërkesa nr. 23754*

23. Kërkesa nr. 23754 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 2 të lëshuar më 17 qershor 2004, që e tregon pronën në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse që aktualisht ka uzurpuar pronën e kërkuar ka paraqitur një kontratë të vërtetuar blerje nr. 854/2009 datë 24 mars 2009, për blerjen e pronës së kërkuar, të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i paraqitësit të kërkesës dhe pala përgjegjëse. Pala përgjegjëse paraqiti gjithashtu një autorizim të vërtetuar me anë të të cilit Paraqitësi i kërkesës ka autorizuar avokatin e tij, Bedri Godanci për të shitur pronën e kërkuar tek pala përgjegjëse. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* një Certifikatë të përditësuar për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr UL-71010022-00202 të datës 28 shkurt 2012, e cila e tregon pronën e kërkuar në emër të palës përgjegjëse. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi Paraqitësin e kërkesës ku e ka informuar për sa më sipër. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur në vitin 2009 dhe se ai nuk kishte kohë për të tërhequr kërkesën. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

g. *Kërkesa nr. 25055*

24. Kërkesa nr. 25055 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht djalit të mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një kontratë blerje nr. 26/1965 të vitit 1965 dhe fletën poseduese që e tregon pronën në emër të bartësit të drejtës pronësore. Pala përgjegjëse deklaron se kunata e tij e ka blerë pronën e kërkuar nga bartësi i së drejtës pronësore dhe ka paraqitur një kontratë blerje nr. 5663/2003, mbi bazën e secilës, janë përditësuar regjistrat kadastralë në vitin 2003 dhe prona e kërkuar është regjistruar në emrin e saj në fletën poseduese nr. 257. Të dyja palët pretendojnë se çmimi fillestar i blerjes nuk ishte pranuar nga bartësi i së drejtës së pronësore, pasi palët e treta të përfshira në proces e kishin mashtruar mbajtësin e së drejtës pronësore për marrjen e çmimit të blerjes. Paraqitësi i kërkesës depozitoi padi pranë Gjykatës Komunale në Pejë më 21 prill 2005 për anulimin e kontratës së blerjes, mbi bazën se transaksioni është falsifikuar. Palët kanë arritur një zgjidhje gjyqësore C. nr. 727/05 më 15 dhjetor 2009, ku pala përgjegjëse ka rënë dakord t'i paguajë mbajtësit të së drejtës pronësore shumën prej 18,500 Euro. Paraqitësi i kërkesës refuzoi të tërheqë kërkesën bazuar në faktin se ekziston edhe një kontest tjetër banesor në pritje për t'u vendosur nga Komisioni. Komisioni konsideron se zgjidhja gjyqësore e lëndës përbën *res judicata* dhe

për këtë arsye kërkesa duhet të hidhet poshtë. Për më tepër, pasi që Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se prona e kërkuar është shitur, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë në këtë bazë.

h. Kërkesat nr. 26113 dhe 26116

25. Kërkesat nr. 26113 dhe 26116 janë paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore, pikërisht vajza e mbajtësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 2004 dhe paraqiti kontratën e blerjes nr. 3295/04 datë 29 dhjetor 2004 dhe fletën poseduese nr. 325, e përditësuar, sipas kontratës së blerjes. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se pronat e kërkuara janë shitur, por se ajo nuk mund të tërhiqte kërkesat e saj. Rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

i. Kërkesa nr. 29145

26. Kërkesa nr. 29145 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën nga paraqitësi i kërkesës dhe paraqiti një kontratë blerje nr. 7325/2009, e vërtetuar nga ana e Gjykatës Komunale në Pejë më 16 shtator 2009 dhe një Certificate të përditësuar për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme që e tregon pronën në emrin e tij. Pasi u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se e kishte shitur pronën tek pala përgjegjëse dhe nuk dëshiron të kërkojë të drejtë ligjore për pronën. Paraqitësi i kërkesës nuk ka mundur të tërheqë kërkesën Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

j. Kërkesa nr. 30668

27. Kërkesa nr. 30668 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht i biri i bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një kontratë të vërtetuar për përkujdesjen jetësore nr. III R. br. 28/95 datë 27 prill 1995, sipas të cilës ai do të trashëgonte pronën e kërkuar pas vdekjes së nënës së tij. Pala përgjegjëse pretendon të drejtat ligjore për pronën e kërkuar, por nuk pranoi të bashkëpunojë me Sekretarinë Ekzekutive. Gjatë përpunimit të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka konfirmuar se e kishte shitur pronën në vitin 2011. Kur iu kërkuar të tërheqë kërkesën, ai refuzoi ta bëjë atë. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

k. Kërkesa nr. 33210

28. Kërkesa nr. 33210 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së saj. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 3501, e cila e tregon pronën në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Prona e kërkuar është trashëguar nga paraqitësi i kërkesës dhe gjashtëmbëdhjetë bashkëpronarë të tjerë në bazë të vendimit të trashëgimisë T.nr. 80/2000 datë 21 shkurt 2003 dhe përditësimet kadastralë janë bërë në bazë të këtij vendimi të trashëgimisë. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi Paraqitësin e kërkesës dhe i kërkoi të paraqesë certifikatën e vdekjes së nënës dhe vendimin e trashëgimisë, të cilat ajo nuk ka mundur t'i paraqitë. Pala përgjegjëse pretendoi se e kishte blerë pronën e kërkuar nga Paraqitësi i kërkesës dhe bashkëpronarët e tjerë në bazë të kontratës së blerjes ov. br. 8220/2008, të nënshkruar në mes të përfaqësuesit të autorizuar të paraqitësit të

kërkesës dhe bashkëpronarëve, Slavisa Vukosavljevic dhe Palës përgjegjëse më 14 qershor 2008, të cilën ai e ka paraqitur si provë. Më tej, pala përgjegjëse theksoi se ua kishte shitur pronën e kërkuar palëve të treta, pra Bajram Elezkurtajt dhe familjes Vukri (Kujtim, Fadil, Flora dhe Besarta). Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme në emër të këtyre palëve të treta dhe kontaktoi Paraqitësin e kërkesës, i cili konfirmoi se prona e kërkuar i ishte shitur palës përgjegjëse. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

l. Kërkesa nr. 34140

29. Kërkesa nr. 34140 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së saj. Paraqitësi i kërkesës pranon se prona e kërkuar i është shitur Shefqet Imerit dhe Isi Murglit dhe kërkon që Komisioni t'i kërkojë Isi Murglit të paguajë shumën e papaguar të blerjes, pasi çmimi i plotë i blerjes nuk është paguar tërësisht. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 1119 që e tregon nënën e saj si pronare të pronës së kërkuar. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* fletën poseduese nr. 140 e regjistruar në emër të Shefqet Imerit, e përditësuar në bazë të kontratës së vërtetuar të të blerjes VR. Nr. 119/2003 të datës 7 shkurt 2003. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi Paraqitësin e kërkesës dhe ajo konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur dhe ra dakord të tërheqë kërkesën. Megjithatë, Paraqitësi i kërkesës ka dështuar ta bëjë këtë. Në këto rrethana kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

m. Kërkesat nr. 36999, 37427 dhe 51521

30. Kërkesat nr 36999, 37427 dhe 51521 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësve të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij në kërkesën nr. 36999 dhe xhaxhait të tij në kërkesat nr. 37427 dhe 51521. Paraqitësi i kërkesës paraqiti kontratën e ndarjes ov. br. 179/95 të datës 16 nëntor 1994 sipas së cilës babait dhe xhaxhait të tij u janë dhënë pronat e kërkuara. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme që i tregon pronat e kërkuara në emrat e bartësve përkatës të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse pretendon se i ka blerë pronat e kërkuara nga bartësit e të drejtave pronësore dhe ka dorëzuar një kontratë blerje të pavërtetuar në lidhje me pronat e kërkuara të datës 11 gusht 2000. Ai shpjegoi se nuk ka mundur të vërtetojë kontratën e blerjes, pasi Gjykata Komunale në Kamenicë kërkon që të gjitha palët të jenë të pranishëm. Sekretaria Ekzekutive kontaktoi Paraqitësin e kërkesës dhe i kërkoi atij të dorëzojë një autorizim nga xhaxhai i tij, pasi ai nuk bie në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare. Pala përgjegjëse nuk arriti ta bëjë këtë. Megjithatë, Paraqitësi i kërkesës ka konfirmuar se pronat e kërkuara ishin shitur nga bartësit e të drejtave pronësore tek pala përgjegjëse më 11 gusht 2000. Rrjedhimisht kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

n. Kërkesa nr. 49412

31. Kërkesa nr. 49412 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 4, që e tregon atë si pronarin e pronës së kërkuar. Pala përgjegjëse pretendon se e kishte blerë pronën e kërkuar nga Paraqitësi i kërkesës dhe paraqiti kontratën e blerjes nr. 186/2000 të datës 1 gusht 2000 e nënshkruar midis Paraqitësit të kërkesës dhe palës përgjegjëse dhe katër vëllezërit e tij. Pasi u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, gruaja e Paraqitësit të kërkesës

konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur në vitin 2000, por refuzoi të tërheqë kërkesën. Rrjedhimisht kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

o. Kërkesat nr. 49642, 49643 dhe 49644

32. Kërkesat nr. 49642, 49643 dhe 49644 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një certifikatë për Drejtat e Pronës të Paluajtshme nr UL 72514014-00240, që e tregon atë si pronar të pronave të kërkuara. Të dy vëllezërit, që aktualisht po përdorin pronën, iu përgjigjën kërkesës dhe pretendojnë se i kanë blerë pronat e kërkuara nga Paraqitësi i kërkesës dhe paraqitën Certifikatën për Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr UL 72514014-00240, që i tregon pronat e kërkuara në emër të një prej palëve përgjegjëse dhe një vendim kadastral 38/2008 të datës 14 shkurt 2008, në bazë të të cilit janë bërë ndryshimet në librat kadastralë. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* një Certifikatë të përditësuar për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. UL 72514014-00240, që i tregon pronat e kërkuara në emër të së njëjtës palë përgjegjëse. Kjo është bazuar në kontratën e blerjes VR Nr. 516/2008 datë 29 janar 2008. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se pronat e kërkuara ishin shitur, por refuzoi të tërhiqte kërkesat, pasi dëshiron të kërkojë kompensim për shfrytëzimin e pronave të kërkuara nga viti 1999 - 2008 nga palët përgjegjëse pa lejen e saj. Rrjedhimisht kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë. Kërkesa për kompensim bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

p. Kërkesa nr. 53652

33. Kërkesa nr. 53652 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht gjyshit të saj. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 26 që e tregon gjyshin e saj si pronar të pronës së kërkuar. Pala përgjegjëse pretendon se babai i Paraqitësit të kërkesës, Sava Ristic, ia kishte shitur pronën e kërkuar atij më 16 shtator 2009 dhe paraqiti një kontratë blerje nr 7475/2009. Ai deklaroi se nuk e ka regjistruar pronën e kërkuar për arsye të tatimit të pronës. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* pesë Certifikata për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, që e tregojnë pronën në emër të palës përgjegjëse. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se babai i saj e kishte shitur pronën e kërkuar në vitin 2009 dhe pasi ajo jetonte jashtë vendit, ajo nuk mund ta tërheqë kërkesën. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

q. Kërkesa nr. 26474

34. Kërkesa nr. 26474 është depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 2034 të datës 6 nëntor 2001, që e tregon pronën në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse Shfaqet Jashari pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 2003. Ai ka paraqitur një kontratë të pavërtetuar të blerjes të lidhur midis mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore dhe përfaqësuesit të palës përgjegjëse Avni Hetemi, datë 26 tetor 2003, dhe një faturë të datës 26 tetor 2003, e hartuar nga avokati i mbajtësit të drejtës pronësore Avni Ibrahimimi për çmimin e plotë të blerjes. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi avokatin e mbajtësit të së drejtës pronësore Avni Ibrahimimi, i cili konfirmoi se shitja dhe pagesa ishin kryer. Po ashtu, pala përgjegjëse paraqiti fletën poseduese nr. 2034 datë 8 gusht 2007 dhe 2 tetor 2007, fletën poseduese nr. 8317 datë 3 shkurt 2004, dhe një kopje të planit nr. 41 datë 2 mars 2003 që e tregojnë

pronën e kërkuar në emër të palës përgjegjëse. Pala përgjegjëse ka dorëzuar një kopje të kontratës së blerjes nr. 236/04 të datës 4 shkurt 2004 të lidhur midis mbajtësit të së drejtës pronësore dhe palës përgjegjëse dhe kontratën e blerjes nr. 2006/5 të lidhur midis palës përgjegjëse dhe vëllait të tij datë 7 qershor 2005. Në bazë të secilës pala përgjegjëse i ka shitur pronën e kërkuar vëllait të tij Ekrem Jashari. Sekretaria Ekzekutive konstatoi *ex officio* se prona e kërkuar është regjistruar gjithashtu në regjistrat kadastralë, në certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 2034 datë 11 maj 2008 dhe 10 prill 2010, në emër të vëllait të palës përgjegjëse Ekrem Jashari. Kur Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës për ta informuar me sa më sipër, paraqitësi i kërkesës vazhdoi të mohojë shitjen. Megjithatë kur Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi palën përgjegjëse ai shpjegoi se vëllai i tij Ekrem Jashari ka interes të përbashkët në pronën e kërkuar dhe për rrjedhojë emri i tij është në disa nga dokumentet.

35. Bazuar në dëshmitë para tij. Komisioni konstaton se paraqitësi i kërkesës e ka shitur pronën e kërkuar në vitin 2003. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

r. Kërkesat nr 00264 dhe 92290

36. Kërkesat nr. 00264 dhe 92290 janë depozituar nga përfaqësuesi i autorizuar i Paraqitësit të kërkesës, i cili kërkon pronat në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposelimin e pronës së kërkuar, në secilën kërkesë për ¼ pjesë ideale të pronës së kërkuar.

37. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar nga babai i bartësit të së drejtës pronësore në vitin 1986 dhe ka pasur posedimin e pronës që nga ajo kohë. Megjithatë, ai pohon se regjistrat kadastralë nuk janë përditësuar. Më tej, ai pohon se i përsëriti kontratat e blerjes me bartësin e së drejtës pronësore në kërkesën nr. 00264 dhe 92290 më 19 korrik 2011 dhe se regjistrat kadastralë janë përditësuar në emër të tij për ½ e pjesës ideale të pronës së kërkuar. Sekretaria Ekzekutive kontaktoi Paraqitësin e kërkesës dhe ai konfirmoi se ai dhe bashkëpronarët e kanë shitur pronën e kërkuar tek pala përgjegjëse dhe se ai do të tërhiqte kërkesat, por nuk e ka bërë këtë. Rrjedhimisht kërkesa nr. 00264 dhe 92290 duhet të hidhen poshtë pasi paraqitësi i kërkesës i ka tjetërsuar ato vullnetarisht.

2. Nuk ka humbje të posedimit për shkak të konfliktit.

a. Kërkesa nr. 00078

38. Kërkesa nr. 00078 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një certifikatë për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 703014035-1287, që e tregon pronën e kërkuar, si pronë shoqërore, në emër të Agjencisë Pyjore të Kosovës; një kopje të padisë të bërë në Gjykatën Komunale në Prishtinë P . 697/61, datë 31 gusht 1961, me të cilën babai i tij kërkon njohjen e të drejtave pronësore për pronën e kërkuar dhe vendimin administrativ 03/8967 të datës 6 korrik 1964, me anë të secilës ankesa e babait të tij kundër vendimit administrativ 649/61 për konfiskimin e pronës së kërkuar nga Komuna e datës 28 shkurt 1963, u refuzua për shkak të mungesës së provave të pronësisë. Paraqitësi i kërkesës pretendon se ka qenë në posedim të pronës së kërkuar, të cilën e ka trashëguar nga gjyshi i tij. Përfaqësuesi i autorizuar i Agjencisë Kosovare të Pyjeve, Murat Lepaja, pretendoi se pala përgjegjëse është pronar i pronës së kërkuar. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* fletën poseduese nr. 190 që e tregon pronën e kërkuar, si pronë shoqërore, në emër të Agjencisë Pyjore të

Kosovës. Sekretaria Ekzekutive kontaktoi Paraqitësin e kërkesës dhe ai konfirmoi se prona e kërkuar ishte konfiskuar nga shteti në vitin 1928 dhe se ai nuk ishte në posedim të pronës së kërkuar në kohën e konfliktit të viteve 1998-1999. Humbje e posedimit nga paraqitësi i kërkesës për pronën e kërkuar nuk është rezultat i rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose që rezultojnë nga konflikti i viteve 1998-1999. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

b. Kërkesa nr. 10014

39. Kërkesa nr. 10014 është depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se e ka blerë pronën e kërkuar nga Nysret Avdiu dhe ka paraqitur kontratën e blerjes nr. 1009/2001 datë 13 nëntor 2001 dhe fletën poseduese nr. 3690 që e tregon pronën në emër të tij. Pala përgjegjëse pretendon se prona i takon familjes së tij dhe se kushëriri i tij Nysret Avdiu e ka shitur pronën e kërkuar pa pasur autorizim. Është iniciuar procedure gjyqësore për këtë rast. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se nuk e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar, si rezultat i konfliktit, pasi ai e ka përfutur pronën në vitin 2001. Rrjedhimisht, pasi nuk ka humbje të posedimit ose paaftësi për të ushtruar të drejtat pronësore për pronën e kërkuar lidhur me konfliktin, kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

c. Kërkesa nr. 10477

40. Kërkesa nr. 10477 është depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Fillimisht Paraqitësi i kërkesës kërkoi pagesën e shumës së papaguar të çmimit të blerjes ose ndryshe riposedimin e pronës së kërkuar. Më vonë, Paraqitësi i kërkesës e ndryshoi kërkesën ku kërkoi vetëm riposedimin e pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se kishte nënshkruar kontratë blerje me palën përgjegjëse, së bashku me katër bashkëpronarë të tjerë më 24 dhjetor 1996. Ai pretendon se Pala përgjegjëse nuk e ka paguar çmimin e plotë të blerjes. Pala përgjegjëse konfirmon se ai nuk e ka paguar çmimin e plotë të blerjes, pasi Paraqitësi i kërkesës ka kërkuar që shuma e mbetur të paguhet në euro, jo në markën gjermane, në kursin e këmbimit prej një euro për një markë gjermane. Kështu, Pala përgjegjëse bëri padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë nr. 1851/2006 më 8 tetor 2006 për përcaktimin e të drejtave të tij pronësore për pronën e kërkuar. Ky procedim është ende në vazhdim. Kërkesa është depozituar më parë në Drejtoratin për Çështje Pronësore Banesore (DÇPB), me kërkesën nr. DS003511, por u refuzua pasi Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB-ja) konstatoi se ajo nuk ishte kërkesë për pronë banesore.

41. Komisioni konstaton se kërkesa ka të bëjë me një kontest të lindur para konfliktit të vitit 1998-99 dhe se paraqitësi i kërkesës nuk e ka humbur posedimin për shkak të konfliktit. Rrjedhimisht kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë. Më tej, në pajtim me nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me ligjin nr 03/L-079, juridiksioni i Komisionit përjashtohet nëse procedimi gjyqësor në lidhje me kërkesën ka filluar para datës 16 tetor 2006, datë në të cilën Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 ka hyrë në fuqi. Pasi procedimi gjyqësor në lidhje me pronën e kërkuar ka filluar nga palët më 8 tetor 2006, kërkesa nuk është në juridiksion të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë edhe mbi këtë bazë.

d. Kërkesat nr. 18245 dhe 18346

42. Kërkesat nr. 18345 dhe 18346 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pretendon se ai është bashkëpronar i pronave të kërkuara me dy vëllezërit e tij. Ai pohon se babai i tij ia ka dhënë pronat e kërkuara Sali Bulakut për t'i përdorur shumë kohë më parë, por Sali Bulaku ua ka shitur pronat të tjerëve. Paraqitësi i kërkesës dhe vëllezërit e tij kanë depozituar padi kundër tij përpara gjykatës në vitin 1980 dhe gjykata ka nxjerrë vendimin P. br. 345/80 në vitin 1981 duke i njohur të drejtën e pronësisë për pronat e kërkuara paraqitësit të kërkesës dhe vëllezërve të tij. Regjistrat kadastrale janë përditësuar në bazë të këtij vendimi. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se është larguar nga Kosova në vitin 1992 me një nga vëllezërit e tij, ndërsa vëllai i tretë ka qëndruar derisa vdiq në vitin 1995. Pas kthimit të tij në Kosovë në vitin 2002, Paraqitësi i kërkesës pretendon se ka konstatuar se pronat e kërkuara ishin uzurpuar nga persona të panjohur.

43. Pala përgjegjëse pohon se i ka blerë pronat e kërkuara nga Sali Bulaku dhe ka ndërtuar disa shtëpi në pronat edhe pse transferimi nuk është regjistruar në Zyrën Kadastrale. Paraqitësi i kërkesës pretendon se ai i ka ofruar palës përgjegjëse për të shitur tokën, i cili e ka refuzuar mbi bazën se pretendon se e ka blerë tashmë atë nga Sali Bulaku në vitet 1970. Paraqitësi i kërkesës depozitoi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër palës përgjegjëse dhe procedimi gjyqësor është ende në vazhdim. Komisioni konstaton se kërkesat kanë të bëjnë një kontest të gjatë familjar që ka lindur para konfliktit të vitit 1998-1999 dhe se Paraqitësit e kërkesës nuk kanë humbur posedimin si pasojë e këtij konflikti. Rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

44. Më tej, në pajtim me nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me ligjin nr 03/L-079, juridiksioni i Komisionit përjashtohet nëse procedimi gjyqësor në lidhje me kërkesën ka filluar para datës 16 tetor 2006, datë në të cilën Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 ka hyrë në fuqi. Pasi procedimi gjyqësor në lidhje me pronën e kërkuar ka filluar në 1980, kërkesat nuk janë në juridiksion të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë edhe mbi këtë bazë

e. Kërkesat nr. 20204, 20205 dhe 20207

45. Kërkesat nr. 20204, 20205 dhe 20207 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se pronat e kërkuara ishin konfiskuar nga shteti dhe i ishin dhuruar Ndërmarrjes Shoqërore Bujqësia në Pejë në vitin 1959. Paraqitësi i kërkesës e kundërshtoi konfiskimin dhe depozitoi padi. Aktgjykimi përfundimtar i Gjykatës Komunale në Pejë P.br. 727/93 i vitit 1997, i ka konfirmuar atij pronësinë e pjesës ideale të 1/5 të pronave të kërkuara. Megjithatë, regjistrat kadastrale nuk janë përditësuar dhe pronat e kërkuara vazhdojnë të jenë të regjistruara si pronë shoqërore. Më tej, Paraqitësi i kërkesës theksoi se Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ka privatizuar pronën e kërkuar në vitin 2005 dhe e ka shitur atë tek NPT Elkos Group. Agjencia e Privatizimit, e cila mori funksionet e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit në vitin 2008, u përgjigj se nuk ishin depozituar kërkesa në lidhje me kërkesat pronësore të paraqitësit të kërkesës. Përfaqësuesi i autorizuar i NPT Elkos Group ka paraqitur kopje të kontratës së blerjes nr. 62/2005 të datës 23 shkurt 2005 të lidhur në mes të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit në emër të Ndërmarrjes Shoqërore Bujqësia në Pejë dhe Palës përgjegjëse dhe fletën poseduese të pjesshme nr. 87 që tregon një kontratë qiraje për 99 vite për pronat e kërkuara në emër të palës përgjegjëse. Pasi u kontaktua nga

Sekretaria Ekzekutive, Paraqitësi i kërkesës ka konfirmuar se ai nuk ka pasur posedimin e pronave të kërkuara në kohën e konfliktit të viteve 1998-1999. Në të vërtetë ai pranoi se nuk ka pasur posedimin e pronave të kërkuara që nga viti 1959, pavarësisht vendimit të gjykatës. Komisioni arrin në përfundimin se humbja e posedimit për pronat e kërkuara nga paraqitësi i kërkesës nuk ishte rezultat i rrethanave që lidhen drejtpërdrejt me ose që rezultojnë nga konflikti i viteve 1998-1999. Rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

f. Kërkesat nr. 21062, 21066, 21068, 21069, 21070, 21071, 28525, 28526, 90374, 90381, 90386 dhe 90387

46. Kërkesat nr. 21062, 21066, 21068, 21069, 21070, 21071, 28525, 28526, 90374, 90381, 90386 dhe 90387 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore. Në kërkesat nr. 21062, 21066, 21068, 21069, 21070 dhe 21071, kërkesat janë depozituar nga i biri i bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore, ndërsa kërkesat nr. 28525, 28526, 90374, 90381, 90386 dhe 90387 janë paraqitur nga nipi i mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore dhe nipi i paraqitësit të kërkesës në kërkesat nr. 21062, 21066, 21068, 21069, 21070 dhe 21071.

47. Kërkesat janë parashtruar nga ana e paraqitësve të kërkesës për parcela të njëjta në emër të bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore. Të dy paraqitësit e kërkesës kërkojnë konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e pronave të kërkuara. Paraqitësit e kërkesave pretendojnë se bartësi i së drejtës pronësore është pronar i ½ e pjesë ideale të pronave të kërkuara, ndërsa vëllai i tij Hasan Gashi është regjistruar si pronar i gjysmës ideale të mbetur të pronave të kërkuara. Sekretari Ekzekutive ka gjetur *ex officio* fletën poseduese nr. 23 e cila konfirmon të drejtat e pretenduara të pronësisë. Megjithatë, mbajtësi i së drejtës pronësore ndërroi jetë në vitin 1994 dhe nuk ka filluar procedura e trashëgimisë.

48. Palët përgjegjëse të kërkesave, Bahri Llugini, Faik Bytyqi, Muhamet Bytyqi, Rexhep Bytyqi dhe Enver Llugini pohojnë se ata i kanë blerë pronat e kërkuara nga djemtë e mbajtësit të së drejtës pronësore Halit Gashi dhe Sadri Gashi në vitin 1986, 1995, 1996, 1997 dhe 2005 respektivisht dhe kanë paraqitur kopjet e kontratave të pavërtetuara të blerjes dhe deklaratat e dëshmitarëve. Kur Sekretaria Ekzekutive i kontaktoi Paraqitësit e kërkesës, ata konfirmuan se të gjithë pronat e kërkuara ishin shitur nga Halit Gashi dhe Sadri Gashi tek pala përgjegjëse Bahri Llugini, Faik Bytyqi, Muhamet Bytyqi, Rexhep Bytyqi dhe Enver Llugini. Paraqitësit e kërkesës e njohin e shitjen, por ata deklarojnë se kërkojnë riposedimin e pronave të kërkuara, sepse Halit dhe Sadri Gashi kanë edhe tetë vëllezër të tjerë dhe kështu Paraqitësit e kërkesave nuk i konsiderojnë ata të autorizuar për të shitur pronat e kërkuara pa pëlqimin e të gjithë trashëgimtarëve të tjerë. Ata pretendojnë se të afërmit e tjerë nuk u kompensuan ose nuk u është dhënë asnjëherë një pjesë e çmimit të blerjes.

49. Komisioni konsideron se nuk ka asnjë dëshmi të humbjes të posedimit ose pamundësisë për të ushtruar të drejtat e pronësisë për pronat e kërkuara e ndërlidhur me konfliktin, por vetëm një kontest familjar që ka lindur para konfliktit. Rrjedhimisht kërkesat duhet të hidhen poshtë pasi bien jashtë juridiksionit të Komisionit

g. *Kërkesa nr. 35303*

50. Kërkesa nr. 35303 është depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht vajza e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 172 të vitit 1967, e cila e tregon mbajtësin e të drejtës pronësore, si pronar i 1/3 pjesë ideale të pronës së kërkuar dhe vendimin e trashëgimisë O. br. 983/06 bazuar në fletën poseduese nr 172, të lëshuar nga Gjykata Komunale në Kralejë, që tregon se ka trashëguar pjesën ideale prej 1/5 të pronës së kërkuar. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive konstatoi *ex officio* se parcela e kërkuar jo vetëm që ishte rriemëruar dhe por u gjet në fletën poseduese nr. 50 e regjistruar në emër të xhaxhait të paraqitësit të kërkesës. Pas ballafaqimit me këtë informacion, paraqitësi i kërkesës pranoi se ka pasur kontest familjar prej një kohë të gjatë për pronën e kërkuar dhe shpjegoi se ajo ishte larguar nga Kosova me familjen e saj në vitin 1982 dhe se xhaxhai i saj i kishte regjistruar më pas të gjitha parcelat e kërkuara në emrin e tij. Pala përgjegjëse, i cili në fillim kishte kërkuar të drejta ligjore për pronën e kërkuar, shpjegoi se ai nuk po e shfrytëzon pronën e kërkuar dhe se ajo ishte shitur nga fëmijët e xhaxhait të paraqitësit të kërkesës tek njëri prej fqinjëve të tij.

51. Komisioni konstaton se Paraqitësi i kërkesës ka humbur posedimin si rezultat i një kontesti familjar dhe jo si pasojë e konfliktit të viteve 1998-1999. Prandaj, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë

h. *Kërkesa nr. 36820*

52. Kërkesa nr. 36820 është depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht gjyshit të tij. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 203, që e tregon pronën në emër të bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore. Gjatë përpunimit të kërkesës, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se gjyshi i tij e kishte shitur pronën e kërkuar më 5 nëntor 1966. Megjithatë, Paraqitësi i kërkesës pretendoi se pasi Pala përgjegjëse nuk e kishte paguar çmimin për 3,62 m² të pronës së kërkuar, ai kërkon riposedimin e kësaj pjese të pronës së kërkuar.

53. Pala përgjegjëse pretendon se familja e tij e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 1966 dhe ka pasur posedimin e saj qysh atëherë. Ai pohon se gjithë dokumentacioni i transaksionit është djegur gjatë luftës, dhe se regjistrat kadastralë nuk ishin përditësuar. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron mbajtësi i së drejtës pronësore prona e kërkuar është shitur para konfliktit dhe kërkesa duhet të refuzohet. Kërkesa për shumën e papaguar të çmimit për pronën e kërkuar prej 3,62 m² bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

i. *Kërkesa nr. 38812*

54. Kërkesa nr. 38812 është depozituar fillimisht nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës së pronësore. Megjithatë, pas verifikimit negativ të vendimit të trashëgimisë, ai ra dakord për të vazhduar me kërkesën si anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës pranoi më vonë se e kishte shkëmbyer pronën e kërkuar me atë të palës përgjegjëse, i cili aktualisht ka uzurpuar pronën e kërkuar, në vitin 1989, në këmbim të dy parcelave të tokës që i përkasin palës përgjegjëse. Paraqitësi i kërkesës më vonë e ndryshoi kërkesën e tij nga konfirmim të pronësisë në kërkesë për të bartur parcelat e shkëmbyera në emrat e palëve

përkatëse në regjistrat kadastralë. Kërkesa e tillë bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

j. Kërkesa nr. 47318

55. Kërkesa nr. 47318 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së saj. Paraqitësi i kërkesës pretendon se prona e kërkuar është shtetëzuar dhe i është dhënë Kombinatit Bujqësor Ratar në Fushë Kosovë në vitin 1964. Pasi Kombinati Bujqësor tani është shpërbërë, ajo kërkon konfirmimin e të drejtave pronësore të nënës së saj për pronën e kërkuar. Sekretaria Ekzekutive ka kontaktuar disa herë Paraqitësin e kërkesës, duke i kërkuar asaj që të dorëzojë dokumentacionin shtesë për të provuar të drejtën e pronësisë për pronën e kërkuar. Si përgjigje për këtë, ajo dorëzoi një skicë të parcelës që tregon emrin e nënës së saj dhe numrin e kontratës së blerjes ov. nr 2156/64 të datës 14 tetor 1964 me Kombinin Bujqësor Ratar në Fushë Kosovë.

56. Pala përgjegjëse pohon se babai i tij e ka blerë pronën e kërkuar nga Ukë Brestovci pas Luftës së Dytë Botërore. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 225, që e tregon pronën e kërkuar, e ndarë tashmë në dy nën-parcela, në emër të Ukë Brestovcit.

57. Komisioni arrin në përfundimin se në mungesë të dëshmive të humbjes së posedimit ose pamundësisë për të ushtruar të drejtat e pronësisë për pronën e kërkuar e ndërlidhur me konfliktin, kërkesa duhet të hidhet poshtë si bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

k. Kërkesa nr. 47588

58. Kërkesa nr. 47588 është depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse pretendon se e ka shkëmbyer një pronë tjetër me Paraqitësin e kërkesës në vitin 1972 për pronën e kërkuar dhe e ka pasur në posedim qysh atëherë. Sipas palës përgjegjëse, ai ka nënshkruar një kontratë shkëmbimi për pronën e kërkuar, por se i ishte djegur së bashku me shtëpinë e tij të vjetër gjatë konfliktit në vitet 1998-1999. Më tej, ai pohon se ka ndërtuar një shtëpi të re në pronë në vitin 2000. Pasi Paraqitësi i kërkesës nuk ishte në gjendje të mirë shëndetësore, u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive djali i paraqitësit të kërkesës, Zoran Vasic, ku u ballafaqua me pretendimet e palës përgjegjëse. Djali i Paraqitësit të kërkesës nuk mundi të konfirmonte shkëmbimin, por shpjegoi se as ai dhe as familja e tij nuk kishte qenë në posedim të pronës së kërkuar që nga viti 1980.

59. Komisioni arrin në përfundimin se në mungesë të dëshmive të humbjes së posedimit ose pamundësisë për të ushtruar të drejtat e pronësisë për pronën e kërkuar e ndërlidhur me konfliktin, kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

3. Kërkesa të hedhura poshtë për shkak të mungesës së juridiksionit për kërkesat që janë paraqitur në gjykatën kompetente para datës së hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

60. Kërkesat nr. 92291 dhe 92292 janë depozituar nga përfaqësuesi i autorizuar i Paraqitësit të kërkesës, i cili kërkon pronat në cilësinë e bartësit të së drejtës

pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e pronës së kërkuar, në secilën kërkesë për ¼ pjesë ideale të pronës së kërkuar.

61. Pala përgjegjëse pretendon se e ka e blerë pronën e kërkuar nga babai i bartësit të së drejtës pronësore Sava Jagodic në vitin 1986 dhe ka pasur posedimin e pronës që nga ajo kohë. Megjithatë, ai pohon se regjistrat kadastralë nuk janë përditësuar.

62. Në kërkesat nr. 92291 dhe 92292 Paraqitësi i kërkesës pretendon se e ka trashëguar pronën e kërkuar nga babai i tij dhe mohon se pronat i janë shitur babait të palës përgjegjëse. Sekretaria Ekzekutive konstatoi *ex officio* se ekziston një kontest i vazhdueshëm në lidhje me pronësinë e pronave të kërkuara para gjykatës, të depozituar në vitin 1980 dhe prona është rikthyer në vitin 2004. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* një vendim të lëshuar nga Gjykata Komunale në Kamenicë C.nr. 260/4, më 21 dhjetor 2009, i cili pezullon përkohësisht procedimin para gjykatës për shkak të vdekjes së Sreten Stevanovic, derisa trashëgimtarët e tij t'i drejtohen gjykatës për të rifilluar procedimin. Sreten Stevanovic kishte depozituar padi në gjykatë kundër Dragutin Slakovic prej të cilit pretendon se i kishte blerë pronat e kërkuara dhe që pastaj ia kishte shitur pronat babait të Paraqitësit të kërkesës, në bazë të kontratës së blerjes të datës 19 gusht 1980. Babai i Paraqitësit të kërkesës është palë në padi në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore.

63. Në pajtim me nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit përjashtohet nëse procedimi gjyqësor në lidhje me kërkesën ka filluar para datës 16 tetor 2006, datë në të cilën Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 ka hyrë në fuqi. Pasi procedimi gjyqësor në lidhje me pronën e kërkuar ka filluar në vitin 1986, kërkesat nr. 92291 dhe 92292 nuk janë në juridiksion të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

4. Kërkesa të hedhura poshtë për mungesë të autorizimit.

64. Në bazë të nenit 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079, kërkesat mund të paraqiten nga bartësi i së drejtës pronësore, anëtar i bashkësisë familjare ose nga personi fizik i autorizuar i cili posedon autorizim të vlefshëm të bërë sipas rregullit nga bartësi i së drejtës pronësore apo anëtar i bashkësisë familjare i atij personi. Në raste të jashtëzakonshme kur paraqiten probleme për sigurimin e autorizimit, Sekretaria mund të vërtetojë një dokument alternativ i cili autorizon përfaqësuesin e paraqitësit të kërkesës.

65. Neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t'i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë banuar apo jo në pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Komisioni ka përcaktuar se, sipas ligjit të aplikueshëm, ky definicion përfshin përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve gjithashtu edhe prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit dhe nipat/mbesat e bartësit të së drejtës pronësore. Megjithatë, këtu nuk përfshihen të afërmit nga lidhja martesore, dajallarët/ xhaxhallarët, tezet/hallat, nipat, mbesat apo kushërinjtë, të cilët duhet të paraqesin autorizimin për përfaqësimin e tyre në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Individët të cilët nuk bien në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare nuk mund të paraqiten si paraqitës të kërkesave por si persona që synojnë të përfaqësojnë paraqitësin e kërkesës.

66. Kërkesa në të cilat personi që depoziton kërkesën nuk është anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, nuk mund të konsiderohet kërkesë e plotë në përputhje me nenin 5.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin. 03/L-079, pasi në kërkesën të tillë nuk është përmbushur kërkesa themelore procedurale, pikërisht autorizimi i mbajtësit të së drejtës pronësore ose anëtarit të bashkësisë familjare.

a. Kërkesa nr. 17662

67. Kërkesa nr. 17662 është depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se më 28 prill 1972, halla e tij e autorizoi atë për të transferuar të gjitha pronat në fletën poseduese nr. 131 tek babai i paraqitësit të kërkesës. Ai paraqiti autorizimin e datës prill 1972, i cili i ishte lëshuar qëllimisht atij nga halla e tij. Megjithatë autorizimi nuk duket të jetë i vlefshëm, pasi në bazë të certifikatës së vdekjes, halla e tij ka ndërruar jetë në mars 1972 dhe ajo nuk ka mundur të lëshojë autorizim në prill 1972; çka është më e rëndësishme, ai ishte i mitur në atë kohë kur pretendohet të jetë lëshuar autorizimi. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi Paraqitësin e kërkesës dhe ai shpjegoi se data në certifikatën e vdekjes ishte i pasaktë, ajo duhet të ishte maj 1972, dhe atij iu dha 15 ditë afat për të ofruar një certifikatë vdekje të re për të cilën ai shpjegoi ai se nuk mund ta bënte. Sekretaria Ekzekutive i kërkoi zyrës së regjistrimit civil për verifikimin e datës së vdekjes së hallës. Zyra e regjistrimit civil konfirmoi se data e vdekjes ishte mars 1972.

68. Rrjedhimisht në mungesë të autorizimit të vlefshëm, kërkesa duhet të hidhet poshtë.

b. Kërkesat nr. 28982, 28983, 28984, 28985 dhe 28986

69. Kërkesat nr. 28982, 28983, 28984, 28985 dhe 28986 janë depozituar nga i njëjti Paraqitësi i kërkesës si në kërkesën nr. 17662 më sipër, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht hallës/tezes së tij. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 128 e cila e tregon hallën/ tezen e tij si pronare të pronave të kërkuara, një autorizim të lëshuar nga halla/tezja e tij në prill 1972. Megjithatë, ashtu si u vërejt më sipër, pasi Paraqitësi i kërkesës ishte i mitur në kohën që pretendohet lëshimi i autorizimit dhe kjo ka ndodhur pas vdekjes së mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore më 10 mars 1972, autorizimi nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Më tej, Paraqitësi i kërkesës paraqiti 4 autorizime të lëshuar nga katër fëmijët e hallës/tezes të cilët e autorizojnë atë për të disponuar me pronën e saj.

70. Kur Sekretaria Ekzekutive i kërkoi Paraqitësit të kërkesës për të ofruar një kopje të vendimit të trashëgimisë për të përcaktuar trashëgimtarët e hallës/tezes së tij, ai deklaroi se procedura trashëgimore është ende në vazhdim para gjykatës në Serbi dhe për rrjedhojë nuk është lëshuar asnjë vendim trashëgimie ende. Pala përgjegjëse ka dorëzuar një deklaratë të shkruar me dorë duke pretenduar se prona e kërkuar i përkisnin paraardhësve të tij dhe i janë dhënë familjes së bartësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse deklaroi se ai i shfrytëzon pronat e kërkuara për kullote për lopët dhe ai dëshiron të blejë pronën e kërkuar.

71. Bazuar në provat para tij, Komisioni arrin në përfundimin, se kërkesa duhet të hidhet poshtë për shkak të dështimit nga ana e Paraqitësit të kërkesës për të ofruar

autorizimin për cilësinë e tij për të paraqitur kërkesë në emër të bartësit të së drejtës pronësore ose të trashëgimtarëve të saj.

c. Kërkesat nr. 51021, 51023 dhe 51024

72. Kërkesat nr. 51021, 51023 dhe 51024 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore, pikërisht vjehrrës së saj. Pasi Paraqitësi i kërkesës nuk bie brenda përkufizimit të anëtarit të bashkësisë familjare, Paraqitësi i kërkesës u kontaktua disa herë nga Sekretaria Ekzekutive në vitin 2008 dhe 2009 dhe iu kërkuar të dorëzojë autorizim të lëshuar nga trashëgimtarët e bartësit të së drejtës pronësore. Megjithatë, Paraqitësi i kërkesës dështoi të paraqitë autorizim. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë.

II Kërkesa jokontestuese

1. Tjetërsimi vullnetar ose aftësia për të ushtruar të drejtën pronësore.

a. Kërkesat nr. 10144 dhe 35778

73. Kërkesat nr. 10144 dhe 35778 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës, në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore për pjesët ideale prej 2/3 dhe 1/3 të pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës në kërkesën nr. 10144, paraqiti një vendim të gjykatës për një kontratë të ndarjes të datës 15 gusht 1983 dhe paraqitësi i kërkesës nr. 35778 paraqiti fletën poseduese të vitit 1993 në mbështetje të kërkesave të tyre. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio*, Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 525, e cila është përditësuar në bazë të kontratës së blerjes nr 1767/09 në vitin 2009, dhe e tregon pronën e kërkuar në emër të Z. Bafti Malokut. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se ata e kishin shitur pronën e kërkuar dhe u zotua se do të tërhiqte kërkesat. Megjithatë, Paraqitësi i kërkesës nuk i ka tërhequr kërkesat. Rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

b. Kërkesa nr. 11052

74. Kërkesa nr. 11052 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese nr. 28 nga kadastra e zhvendosur e cila e tregon babain e tij si pronar të pronës së kërkuar dhe një vendim të trashëgimie nr. 128/2000 të datës 11 prill 2002, e lëshuar nga një gjykatë paralele në Prishtinë, sipas të cilës Paraqitësi i kërkesës ka trashëguar pjesën ideale prej 1/3 të pronës së kërkuar. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 571-1, e cila është përditësuar në bazë të kontratës së blerjes nr 1847/03 të datës 7 gusht 2003 dhe e tregon pronën e kërkuar në emër të një pale të tretë, Z. Bahtjar Rexhep Lohaj. Kur u ballafaqua me sa më sipër nga Sekretaria Ekzekutive, Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se prona e kërkuar është shitur dhe ra dakord të tërheqë kërkesën. Megjithatë, Paraqitësi i kërkesës nuk e ka tërhequr kërkesën. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

c. Kërkesat nr. 19268, 19269, 19270 dhe 19271

75. Kërkesat nr. 19268, 19269, 19270 dhe 19271 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Kërkesat nr. 19269, 19270 dhe

19271 kanë qenë subjekt i një vendimi të hershëm të Komisionit. Megjithatë vendimi i mëparshëm për këto tri kërkesa u shfuqizua nga Komisioni për shkak të notifikimit të pasaktë të pronave të kërkuara gjatë përpunimit të kërkesave nga ana e Sekretarisë Ekzekutive të cilat janë identifikuar pas marrjes së vendimit. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar dhe korrigjimit të gabimeve të tjera të përpunimit.

76. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 94, që e tregon babanë e tij si pronar të pronave të kërkuara, certifikatën e vdekjes së babait dhe një vendim të trashëgimisë O. br. 1071/01 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Krlevë, datë 14 qershor 2012, mbi bazën e secilit ai ka trashëguar pronat e kërkuara. Megjithatë, më 5 prill 2011, Paraqitësi i kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se i kishte shitur pronat e kërkuara dhe se ai do të tërhiqte kërkesat. Megjithatë, pavarësisht faktit se atij iu dërgua një njoftim nga Sekretaria Ekzekutive për hedhjen poshtë të kërkesës nëse ai nuk e tërhiqte kërkesën, Paraqitësi i kërkesës nuk i ka tërhequr kërkesat. Rrjedhimisht kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen hidhet poshtë.

d. Kërkesat nr. 22047, 22048 dhe 22050

77. Kërkesat nr. 22047, 22048 dhe 22050 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr 133, që e tregon atë dhe motrën e saj si bashkëpronarët e pronave të kërkuara dhe një vendim të trashëgimisë o.br. 187/05 të datës 12 korrik 2006 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Pejë, me të cilën ajo ka trashëguar pjesën e motrës së saj të pronave të kërkuara. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio*, Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 133, që i tregon pronat e kërkuara në kërkesën nr. 22047 dhe 22048, në emër të Zeqir Avdylajt, e përditësuar sipas kontratës së blerjes nr. 4681/10 të datës 14 korrik 2010. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur gjithashtu *ex officio*, Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 1859, që e tregon pronën e kërkuar në kërkesën nr. 22050, në emër të Xhemajl Mulliqit, e përditësuar sipas kontratës së blerjes nr. 409/08 datë 23 janar 2008. Paraqitësi i kërkesës është kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive dhe ajo konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur dhe ra dakord për tërheqjen e kërkesave. Megjithatë, ajo nuk i ka tërhequr kërkesat. Rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

e. Kërkesa nr. 22483

78. Kërkesa nr. 22483 është depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur tek ndërmarrja private Friuli Imobiliare në vitin 2007. Megjithatë, kërkesa nuk është tërhequr. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

f. Kërkesa nr. 26121

79. Kërkesa nr. 26121 është depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të saj. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 23, i cila e tregon pronën e kërkuar në emër të bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* fletën poseduese nr. 325, e cila e tregon pronën e kërkuar në emër të një pale të tretë, Zeqir Jahir Sylejmanit. Kur u ballafaqua me informacionin, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur tek Zeqir Jahir Sylejmani në

vitin 2004. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

g. Kërkesat nr. 30776, 30778, 30779, 39782, 30783, 30786 dhe 30787

80. Kërkesat nr. 30776, 30778, 30779 dhe 30787 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht djali i tij dhe kërkesat nr. 30782, 30783 dhe 30786 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Kërkesat nr. 30776 dhe 30779 janë në lidhje me të njëjtën pronë. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 185 nga kadastra e zhvendosur që e tregon bartësin e së drejtës pronësore si pronar të pronave të kërkuara dhe një vendim trashëgimie nr. 26/06 të datës 22 mars 2005 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Gjilan, me anë të të cilit ai ka trashëguar pronat e kërkuara nga bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 69, që e tregon pronën e kërkuar në emër të Bajram Demirit. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive dhe u informua për sa më sipër, Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se pronat e kërkuara ishin shitur prej tij dhe se ai do të tërhiqte kërkesat. Megjithatë, Paraqitësi i kërkesës nuk i ka tërhequr kërkesat. Rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

h. Kërkesa nr. 44613

81. Kërkesa nr. 44613 është depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht djalit të mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti aktgjykimin nr. 792/97, të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prizren më 15 prill 1998, me anë të secilit kontratat e blerjes ov. nr 362/63 dhe OV nr 363/62, e lidhur në mes gjyshit të tij dhe Ndërmarrjes PIK Progress u shpallën të pavlefshme dhe të drejtat pronësore iu transferuan pasardhësve të gjyshit të tij, duke përfshirë edhe babain e tij. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 753, që e tregon pronën e kërkuar në emër të një pale të tretë, Remzi Safet Amzës, e përditësuar në bazë të kontratës së blerjes nr. 1570/2007 të datës 23 mars 2007. Paraqitësi i kërkesës u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive dhe u informua për sa më sipër. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se e kishte shitur pronën e kërkuar, megjithatë ai nuk e ka tërhequr kërkesën. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

i. Kërkesat nr. 47603, 47604, 47605 dhe 47786

82. Kërkesat nr. 47603, 47604, 47605 dhe 47786 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti kontratën e dhurimit nr. 884/84 të datës 21 shtator 1984 dhe një vendim trashëgimie T. nr. 104/2003 të datës 14 tetor 2003, në pajtim me të cilat ai ka marrë pronat e kërkuara nga babai i tij. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio*, Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 70, i cila e tregon pronën e kërkuar në emër të një pale të tretë, Z. Faik Rifat Zeqiri, dhe e cila është përditësuar në pajtim me kontratën e blerjes VR. nr. 1826/09 datë 21 korrik 2009 dhe Vr.nr. 1201/2008 të datës 7 maj 2008. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, Paraqitësi i kërkesës shpjegoi se pronat e kërkuara ishin shitur në vitin 2008 dhe 2009. Megjithatë, kërkesat nuk janë tërhequr. Rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

j. Kërkesat nr. 54982, 54984, 54989 dhe 54990

83. Kërkesat nr. 54982, 54984, 54989 dhe 54990 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht djali e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e pronave të kërkuara. Paraqitësi i kërkesës paraqiti aktgjykimin nr. 792/97, të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prizren më 15 prill 1998, me anë të secilës kontratat e blerjes ov. nr 362/63 dhe OV nr 363/62, të lidhura në mes gjyshit të tij dhe Ndërmarrjes PIK Progress u shpallën të pavlefshme dhe të drejtat pronësore iu transferuan pasardhësve të gjyshit të tij, duke përfshirë edhe babain e tij. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* e Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 1623, 1105 dhe 1710, që i tregojnë pronat e kërkuara në emrat e palëve të treta, të përditësuara në pajtim me kontratat e blerjes me këto palë të treta. Paraqitësi i kërkesës u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive dhe u informua për sa më sipër. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se i kishte shitur pronat e kërkuara, megjithatë, ai nuk i ka tërhequr kërkesat. Rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

2. Humbje e posedimit jo për shkak të konfliktit.

a. Kërkesat nr. 31501, 31502, 31503, 31504, 31505, 31510, 31513 dhe 31544

84. Kërkesat nr. 31501, 31502, 31503, 31504, 31505, 31510, 31513 dhe 31544 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletët poseduese nr. 181 dhe 10, që i tregojnë pronat e kërkuara në emrin e tij dhe një vendim trashëgimie nr. 12/88 datë 8 mars 1988, sipas të cilit ai i ka trashëguar pronat e kërkuara nga babai i tij. Ai paraqiti gjithashtu një autorizim të datës 11 qershor 2002, me të cilin e ka autorizuar Z. Liman Hasa për të shitur pronat e kërkuara. Ai pretendon se Z. Liman Hasa e ka keqpërdorur autorizimin dhe ka transferuar pronat e kërkuara në emrin e tij. Komisioni vëren se kërkesa e paraqitësit të kërkesës rrjedh nga një keqpërdorim i pretenduar i autorizimit të lëshuar pas konfliktit të 1998-99 dhe jo nga konflikti. Rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

b. Kërkesat nr. 41154 dhe 41159

85. Kërkesat nr. 41154 dhe 41159 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 490, që i tregojnë pronat e kërkuara në emrin e tij. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 63, që e tregojnë pronën e kërkuar në emër të babait të tij. Paraqitësi i kërkesës paraqiti deklaratën me shkrim më 21 prill 2008 dhe 19 maj 2008, në të cilat shpjegoi se ai u largua për Topolan në Serbi, më 4 nëntor 2011 për shkak të mungesës së lirisë së lëvizjes dhe për arsimim dhe mundësi punësimi më të mirë për fëmijët e tij. Ai deklaroi se nipi i tij e ka shfrytëzuar pronën me lejen e tij. Rrjedhimisht, nuk ka humbje të posedimit apo të drejtave të tjera pronësore për shkak të konfliktit të 1998-99 dhe kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

c. Kërkesa nr. 45258

86. Kërkesa nr. 45258 është depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht djalit të mbajtësit të së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi Paraqitësin e kërkesës për t'u informuar se kur familja e tij e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës pranoi se familja e tij nuk ka humbur posedimin e pronës së kërkuar, si pasojë e konfliktit të viteve 1998-1999. Paraqitësi i kërkesës shpjegoi se familja e tij u largua nga Kosova pas konfliktit dhe shkoi në Smederevo në Serbi, ku ai banon ende dhe nipi i tij e ka shfrytëzuar pronën e kërkuar me lejen e tij që nga ajo kohë. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

d. Kërkesat nr. 47107, 47108, 47110, 47111, 47112 dhe 47113

87. Kërkesat nr 47107, 47108, 47110, 47111, 47112 dhe 47113 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore, pikërisht motrës së tij. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 9 që i tregon pronat e kërkuara në emër të motrës së tij. Sekretaria Ekzekutive e ka kontaktuar disa herë Paraqitësin e kërkesës për t'i shpjeguar se motra e tij kishte dorëzuar tashmë kërkesat e saj për pronat e kërkuara; megjithatë paraqitësi i kërkesës nuk i ka tërhequr kërkesat. Rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

e. Kërkesat nr. 47194, 47195, 47196, 47197, 47198, 47199, 47200, 47201, 47202, 47204, 47205, 47206, 51710, 51711, 51713, 51714 dhe 51715

88. Kërkesat nr. 47194, 47195, 47196, 47197, 47198, 47199, 47200, 47201, 47202, 47204, 47205, 47206, 51710, 51711, 51713, 51714 dhe 51715 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore, pikërisht djalit të mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese nr. 68 që i tregon pronat e kërkuara në emër të bartësit të së drejtës pronësore dhe një vendim të trashëgimie O. br. 11 /8 të datës 19 qershor 2008, të lëshuar nga një gjykatë paralele në Kamenicë, sipas të cilit ai ka trashëguar pronat e kërkuara nga mbajtësi i së drejtës pronësore. Për kërkesat nr. 47205 dhe 47206, Paraqitësi i kërkesës paraqiti edhe fletën poseduese nr. 57, që i tregon pronat e kërkuara në emër të nënës së mbajtësit të së drejtës pronësore dhe një kontratë dhurimi OV. nr. 335/89, datë 3 maj 1985, sipas të cilit bartësi i së drejtës pronësore i ka marrë pronat e kërkuara nga nëna e tij. Paraqitësi i kërkesës paraqiti edhe certifikatën e tij të lindjes dhe certifikatën e vdekjes së nënës. Ka pasur një mospërputhje në emrin a mbajtësit të së drejtës pronësore në certifikatën e lindjes dhe certifikatën e vdekjes, ku ajo është e shënuar si Mirsa Stoilkovic e ndërsa në fletën poseduese është shënuar Mirsa Andjeljkovic. Sekretaria Ekzekutive e ka kontaktuar disa herë Paraqitësin e kërkesës, duke i kërkuar atij për të sqaruar mospërputhjen e emrit dhe të paraqitë një dokument të vërtetuar për këtë qëllim. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi Paraqitësin e kërkesës më në fund më 28 mars 2012, ku ai pranoi se nuk e ka humbur posedimin e pronave të kërkuara si pasojë e konfliktit të viteve 1998-1999. Ai shpjegoi se ishte larguar në vitin 1999 kryesisht për arsye ekonomike dhe pronat e tij gjenden në një lagje serbe, kështu që ato nuk janë të uzurpuara. Ai pranoi se tani banon në Kosovë dhe po i shfrytëzon pronat e kërkuara. Rrjedhimisht në mungesë të humbjes së posedimit për shkak të konfliktit, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

f. Kërkesat nr. 50327 dhe 50328

89. Kërkesat nr 50327 dhe 50328 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore, pikërisht djalit të mbajtësit të së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi Paraqitësin e kërkesës për informacion shtesë se kur familja e tij ka humbur posedimin e pronave të kërkuara; paraqitësi i kërkesës pranoi se familja e tij u largua nga Kosova në vitin 1970 dhe u vendos në Serbi, ku ai ende banon sot. Më tej pranoi se pronat e kërkuara gjenden në një lagje serbe dhe janë shfrytëzuar nga të afërmit e tij. Rrjedhimisht në mungesë të humbjes së posedimit për shkak të konfliktit, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

g. Kërkesa nr. 51705 dhe 51706

90. Kërkesat nr. 51705 dhe 51706 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht vëllai i tij. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese nr. 188, që e tregon vëllain dhe nënën e tij, secilin si bashkëpronar të ½ të pronave të kërkuara. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një vendim trashëgimi O. br. 11/8 datës 19 qershor 2008, të lëshuar nga një gjykatë paralele në Kamenicë, sipas të cilit ai trashëgoi ½ e pronave të kërkuara nga bartësi i së drejtës pronësore. Bartësi i së drejtës pronësore u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, pasi Paraqitësi i kërkesës nuk kishte paraqitur dokumente që provojnë marrëdhënien e tij me bartësin e së drejtës pronësore. Bartësi i së drejtës pronësore konfirmoi se Paraqitësi i kërkesës është vëllai i tij. Kur Sekretaria Ekzekutive kontaktoi Paraqitësin e kërkesës për herën e fundit më 28 mars 2012, ai pranoi se ata nuk kanë humbur posedimin e pronave të kërkuara, si pasojë e konfliktit të viteve 1998-1999. Ai sqaroi se pronat gjenden në një lagje serbe dhe nuk janë të uzurpuara në mënyrë të paligjshme. Rrjedhimisht në mungesë të humbjes së posedimit për shkak të konfliktit, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

h. Kërkesat nr. 90019, 90155, 90162 dhe 91604

91. Kërkesat nr. 90019, 90155, 90162 dhe 91604 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar një vendim trashëgimie nr. 12/88 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Kaçanik, datë 8 mars 1988, me të cilin ka trashëguar pronat e kërkuara nga babai i tij dhe fletën poseduese nr. 10 nga kadastra e zhvendosur që e tregon atë si pronar të pronave të kërkuara. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* fletën poseduese nr. 465, e cila e tregon Ndërmarrjen Bujqësore Limani si pronare të pronave të kërkuara. Fleta poseduese është përditësuar në bazë të kontratës së blerjes nr. 1347/03 të datës 3 dhjetor 2003, nëpërmjet të cilës parcelat në fletën poseduese nr. 10 i janë transferuar Ndërmarrjes Bujqësore Limani, bazuar në autorizimin e lëshuar nga Paraqitësi i kërkesës për Z. Liman Hasani, pronar i Ndërmarrjes Bujqësore Limani, ku e autorizon atë për të shitur pronat e kërkuara në emër të tij. Paraqitësi i kërkesës paraqiti autorizimin e datës 11 qershor 2002, megjithatë, kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës në fillim mohoi se e ka lëshuar autorizimin. Me pas paraqitësi i kërkesës pranoi se e kishte lëshuar autorizimin por se Z. Liman Hasani e kishte keqpërdorur autorizimin për transferimin e pronave të kërkuara në emrin e tij.

92. Komisioni vëren se kërkesa e paraqitësit të kërkesës nuk ngre çështje shtrëngimi, për të cilin Komisioni mund të kishte juridiksion për ta trajtuar, por më tepër është një

çështje e keqpërdorimit të autorizimit, që duhet të trajtohet nga gjykatat vendore. Rrjedhimisht në mungesë të dëshmisë për humbje të posedimit ose pamundësisë për të ushtruar të drejtat e pronësisë për pronën e kërkuar e ndërlidhur me konfliktin, kërkesa duhet të hidhet poshtë si bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

i. Kërkesat nr. 91801 dhe 91802

93. Kërkesat nr. 91801 dhe 91802 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht djali i mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 170, e cila e tregon pjesën ideale të 2/3 të pronave të kërkuara në emër të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 348 dhe 349 që i tregon pronat e kërkuara në emrat e dy xhaxhallarëve të Paraqitësit të kërkesës si të vetmit bashkëpronarë. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi Paraqitësin e kërkesës ku i kërkoi informacione shtesë për të vërtetuar bashkëpronësinë e babait të tij për pronat e kërkuara. Pasi ai nuk mundi të sigurojë prova të tillë, Paraqitësit të kërkesës iu kërkua të ofrojnë autorizim nga xhaxhallarët, në emrat e të cilëve është regjistruar aktualisht prona apo nga trashëgimtarët e tyre. Paraqitësi i kërkesës pranoi se trashëgimtarët nuk duan ta autorizojnë atë për të vepruar në emër të tyre. Kur u pyet nëse familja e tij ka humbur posedimin e pronave të kërkuara, si rezultat i konfliktit të viteve 1998-1999, Paraqitësi i kërkesës pranoi se familja e tij nuk e humbur posedimin si pasojë e konfliktit të viteve 1998-1999. Ai shpjegoi se familja e tij u largua nga Kosova në vitin 1970 dhe u vendos në Serbi, ku banon ende, dhe se pronat e kërkuara ndodhen në një lagje serbe dhe shfrytëzohen nga të afërmit e tij. Rrjedhimisht në mungesë të humbjes së posedimit për shkak të konfliktit, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

3. Res judicata

a. Kërkesa nr. 23313

94. Kërkesa nr. 23313 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 281 që e tregon atë si bashkëpronar të pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur më parë kërkesën nr. 23314 për të njëjtën pronë, e cila është vendosur nga Komisioni në shtator 2011. Sekretaria Ekzekutive e pyeti djalin e paraqitësit të kërkesës, pasi paraqitësi i kërkesës ishte e sëmure, nëse dëshiron të tërheqë kërkesën, por Paraqitësi i kërkesës refuzoi ta bëjë këtë. Komisioni konsideron se vendimi i mëparshëm për të njëjtën çështje përbën *res judicata* dhe rrjedhimisht kërkesa nr. 23313 duhet të hidhet poshtë.

b. Kërkesat nr. 50540, 50552, 50553, 50554, 50555, 50556 dhe 50557

95. Kërkesat nr. 50540, 50552, 50553, 50554, 50555, 50556 dhe 50557 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 73 që i tregon pronat e kërkuara në emrin e tij si bashkëpronar i 1/3 pjesë ideale të pronave të kërkuara dhe një kontratë për përkujdesjen jetësore nr. 3177/84 të datës 14 nëntor 1984, që i ndan pronat e kërkuara në emrat e Paraqitësit të kërkesës dhe të dy bashkëpronarëve të tjerë, përkatësisht babait dhe resë së babait dhe më tej transferimin e pjesës së babait për pronat e kërkuara tek

Paraqitësi i kërkesës pas vdekjes së të dyve babait dhe nënës të tij, duke i dhënë Paraqitësit të kërkesës pjesën prej 2/3 të pronave të kërkuara. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës dhe i kërkoi të dorëzojë një kopje të certifikatave të vdekjes të prindërve të tij. Paraqitësi i kërkesës pohoi se ata kanë vdekur më 19 gusht 1986 dhe 13 shkurt 1987, përkatësisht, por nuk arriti të dorëzojë një kopje të certifikatave të vdekjes. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* vendimin për konsolidimin e tokës nr. 461-428-84 datë 14 shtator 1987 dhe procesverbalin datë 28 maj 1984, të cilat përfshijnë transferimin e pronave të kërkuara tek Paraqitësi i kërkesës në bazë të kontratës për përkujdesjes jetësore dhe kanë konsoliduar pesëmbëdhjetë parcelat në pesë parcela me numra të rinj të parcelave.

96. Komisioni vëren se Paraqitësi i njëjtë i kërkesës ka depozituar kërkesat nr. 50547, 50548, 50549, 50550 dhe 50551 në lidhje me të njëjtat prona si në kërkesat nr. 50540, 50552, 50553, 50554, 50555, 50556 dhe 50557. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 430, të cilat e tregojnë paraqitësin e kërkesës si pronar të 1/1 të pesë numrave të parcelave të tokës që fillimisht ishin pesëmbëdhjetë e më pas u konsoliduan. Tërësia e pronave të kërkuara përfshihen në kërkesat nr. 50547, 50548, 50549, 50550 dhe 50551, të cilat janë miratuar me vendimin e Komisionit KPCC/D/A/147/2012 të datës 19 prill 2012. Kështu pjesa e mbetur prej shtatë kërkesash, përkatësisht kërkesat nr. 50540, 50552, 50553, 50554, 50555, 50556 dhe 50557 duhet të refuzohen pasi subjekti lëndor i tyre përfshihet në pesë kërkesat e miratuara.

4. *Kërkesa të hedhura poshtë për shkak të mungesës së autorizimit.*

97. Kërkesat nr. 44819, 44820, 44824, 44827, 44829, 44831, 44833, 44837, 44838, 44842, 44844 dhe 44846 janë depozituar nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës të pronësore, pikërisht resë së mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletët poseduese nr. 9 dhe 89 që i tregon pronat e kërkuara në emër të bartësit të së drejtës pronësore dhe certifikatën e saj të martesës. Pasi Paraqitësi i kërkesës nuk bie në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare, Paraqitësi i kërkesës u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive tri herë dhe iu kërkua secilën herë që të paraqesë autorizim të lëshuar nga trashëgimtarët e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës shpjegoi se ajo nuk mund të paraqesë autorizimin, pasi burri i saj ka vdekur dhe fëmijët e saj nuk jetojnë në Serbi. Kur u kontaktua herën e fundit, ajo ka deklaruar se nuk kishte filluar asnjë procedurë trashëgimie dhe se marrja e autorizimit kërkonte kohë.

98. Rrjedhimisht pasi paraqitësi i kërkesës nuk paraqiti autorizim të vlefshëm, kërkesat duhet të hidhen poshtë.

99. Komisioni konstaton se kërkesat e përfshira në këtë seksion B duhet të hidhen poshtë për mungesë të juridiksionit, për arsytet e mësipërme.

C. *Kërkesa të refuzuara.*

100. Në bazë të nenit 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 Komisioni mund të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze. Kërkesat mund të refuzohen nga Komisioni nëse paraqitësi i kërkesës, ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, nuk kanë mundur të dëshmojnë interesin për drejtat e tyre pronësore dhe të shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

101. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin nr 03/L-079, Komisioni ka kompetencë për të vendosur kërkesat e së drejtës pronësore ose të shfrytëzimit për pronën e paluajtshme. Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të marrë në konsideratë çfarëdo prova të besueshme, të cilat ai i konsideron të rëndësishme për kërkesën, përfshirë dëshmitë e paraqitura nga ana e Sekretarisë Ekzekutive lidhur me besueshmërinë e të dhënave publike. (Neni 6.2 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Komisioni mund të kërkojë nga Sekretaria për të marrë më shumë informacion nga një palë, ose për të kryer hetime shtesë në lidhje me ndonjë kërkesë (neni 6,3 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të drejtohet, por nuk është e detyruar nga rregullat e marrjes së dëshmive të aplikuara në gjykatat vendore në Kosovë (pika 6,1 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079).

I. Kërkesa kontestuese

a. Kërkesat nr. 06248 dhe 06250

102. Kërkesat nr. 06248 dhe 06250 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij.

103. Palët përgjegjëse të dy kërkesave pohojnë se familjet e tyre kanë blerë pronat e kërkuara nga babai i paraqitësit të kërkesës. Sipas pretendimeve të palës përgjegjëse prona e kërkuar në kërkesën nr. 06250 u ble në vitin 1978 dhe prona e kërkuar në kërkesën nr. 06248 në vitin 1972 respektivisht. Pala përgjegjëse në kërkesën nr. 06248 pohoi se pagesa është bërë në prani të katër dëshmitarëve dhe se ai kishte depozituar padi para Gjykatës Komunale në Malishevë për njohjen e të drejtave të pronësisë për pronën e kërkuar dhe se procedura është ende në vazhdim. Djali i palës përgjegjëse në kërkesën nr. 06250 pohoi se transaksioni është regjistruar në regjistrat kadastralë në vitin 2011.

104. Gjatë përpunimit të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka pranuar se babai i tij i kishte shitur pronat e kërkuara tek familjet e palës përgjegjëse në vitin 1972 dhe 1978. Ai pretendon se palët përgjegjëse nuk i kanë paguar çmimin e plotë të blerjes dhe afërsisht 15000 deri 16000 marka gjermane e çmimit të blerjes ishin akoma papaguar. Paraqitësi i kërkesës i kërkon Komisionit të detyrojë palën përgjegjëse për të paguar shumën e papaguar. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se pronat e kërkuara ishin shitur para konfliktit. Rrjedhimisht mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore nuk ka pasur të drejta pronësore menjëherë para ose pas konfliktit të 1998-99 dhe kërkesa duhet të hidhet poshtë. Për më tepër, Komisioni vëren se nuk ka juridiksion të miratojë kërkesën e paraqitësit të kërkesës për pagesën e shumës së papaguar, kërkesë e cila duhet të hidhet poshtë. Vendimi i Komisionit nuk e cenon të drejtën e paraqitësit të kërkesës për të kërkuar kompensimin e pjesës së çmimit të blerjes që ai pretendon se nuk është paguar, nëse është e nevojshme, para gjykatave kompetente vendore.

b. Kërkesat nr. 08677, 08681, 08683, 08684, 08685, 92487 dhe 92488

105. Kërkesat nr. 08677, 08681, 08683, 08684, 08685, 92487 dhe 92488 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pra vajzës së saj. Në kërkesat nr. 08677, 08681, 08683, 08684, 92487 dhe 92488 pala përgjegjëse paraqiti një kontratë me shkrim

të datës 8 janar 1974 sipas secilës pronat e kërkuara janë blerë prej familjes Aliaj nga familja Jovovic. Pala përgjegjëse paraqiti edhe një faturë të datës 1 maj 1974 për pagesën e kështit të fundit të çmimit të blerjes nga ana e blerësve dhe një aktgjykim të Gjykatës Komunale në Pejë C. nr. 1204-1205, i cili ka bërë të vlefshëm kontratën e blerjes dhe e ka transferuar atë në emër të familjes Alijaj në vitin 2008 dhe ka hyrë në fuqi më 2 nëntor 2009. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës dhe ajo konfirmoi se pronat e kërkuara ishin shitur nga burri i saj para se të vdiste në vitin 1998.

106. Parcela e tokës nr. 2/4 e kërkuar në kërkesën nr. 08685 nuk është përfshirë në kontratën e blerjes ose aktgjykimin e Gjykatës Komunale të vitit 2008. Pala përgjegjëse pretendon se i ka blerë të gjitha pronat e kërkuara nga familja Jovović, duke përfshirë ngastrën nr. 2/4, të cilën ai pretendon se e kishte blerë dy herë, së pari në vitin 1974 dhe pastaj përsëri në vitin 1996 ose 1997. Ai propozoi të sjellë dy dëshmitarë që të dëshmojnë për këtë fakt dhe ka paraqitur deklarata nga këta dy dëshmitarë. Pala përgjegjëse shpjegoi se parcela e tokës ishte blerë, pa e ditur se ajo ishte klasifikuar si pronë shoqërore, por gjatë vitit 1997, familja Jovović e kishte regjistruar atë në emrat e shtatëmbëdhjetë bashkëpronarëve të familjes Jovović, duke përfshirë bartësin e së drejtës pronësore. Kur Sekretaria Ekzekutive kontaktoi paraqitësin e kërkesës, ajo tha se ndoshta parcela e tokës ishte shitur, megjithatë ajo nuk ishte i sigurt nëse ajo ishte shitur dhe nuk e dinte pse nuk ishte përfshirë në kontratën e blerjes. Ajo ra dakord të tërheqë kërkesën e saj nr. 08685, pas vendosjes së kërkesave të ndërlidhura. Sekretaria Ekzekutive u përpoq të sigurojë informacion shtesë për parcelën e tokës së shitur nga bashkëshorti i saj, por nuk u bë e mundur kontakti me atë.

107. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të tregojë të drejtën e pronësisë ose posedimit për pronën e kërkuar para ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

c. Kërkesat nr. 11665, 11666 dhe 11673

108. Kërkesat nr. 11665, 11666 dhe 11673 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht, njerikut të tij. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 32 që i tregon pronat e kërkuara në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse në kërkesat nr. 11665 dhe 11666 dhe pala përgjegjëse në kërkesën nr. 11673 të dy pretenduan se i kanë blerë pronat e kërkuara dhe se ata kanë qenë në posedim të pronave të kërkuara që nga viti 1990. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se pronat e kërkuara i ishin shitur palës përgjegjëse në vitet 1990. Paraqitësi i kërkesës pranoi gjithashtu se transferimet nuk janë formalizuar, megjithatë ai refuzoi të tërheqë kërkesat.

d. Kërkesat nr. 13694, 13695 dhe 13697

109. Kërkesat nr. 13694, 13695 dhe 13697 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar fletën poseduese nr. 38 që i tregon pronat e kërkuara në emër të babait të tij. Palët përgjegjëse pretendojnë se i kanë blerë pronat e kërkuara nga bartësi i së drejtës pronësore para konfliktit të viteve 1998-1999. Palët përgjegjëse kanë paraqitur si dëshmi kontratat e pavërtetuara të blerjes. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi më pas se pronat e kërkuara i ishin shitur palëve përgjegjëse dhe premtoi se do të tërhiqte kërkesat. Megjithatë, ai dështoi ta bëjë këtë.

e. Kërkesa nr. 17905

110. Kërkesa nr. 17905 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht djalit të bartësit të së drejtës pronësore Paraqitësi i kërkesës konfirmoi më pas se prona e kërkuar i është shitur familjes Zeqirovic në vitin 1973. Megjithatë, kërkesa nuk është tërhequr.

f. Kërkesa nr. 20185

111. Kërkesa nr. 20185 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 99 që e tregon paraqitësin e kërkesës si bashkëpronar të pronës së kërkuar. Palët përgjegjëse pretendojnë se e kanë blerë pronën e kërkuar në vitin 1980 dhe paraqitën aktgjykimin e gjykatës C. Nr. 301/08 të datës 23 korrik 2008, i cili konfirmon se palët përgjegjëse e kanë blerë pronën e kërkuar nga Paraqitësi i kërkesës dhe bashkëpronarët e tjerë të pronës së kërkuar. Ndryshimet kadastrale janë bërë në bazë të aktgjyimit në emrat e palëve përgjegjëse. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se prona e kërkuar u është shitur palëve përgjegjëse në vitin 1980, por kërkoi kompensim për taksat e paguara prej tij për pronën deri në vitin 1999. Komisioni vëren se nuk ka juridiksion për të miratuar këtë mjet ligjor.

g. Kërkesa nr. 22266

112. Kërkesa nr. 22266 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar nga nëna e të paraqitësi i kërkesës në vitin 1974 dhe që atëherë ka qenë në posedim të vazhdueshëm të pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës pranon në një deklaratë me shkrim se prona e kërkuar i ishte shitur nga nëna e tij në vitin 1974, Enver Brutit, palës përgjegjëse dhe se mbajtësi i së drejtës pronësore dhe familja e tij u larguan nga Kosova në vitin 1975. Paraqitësi i kërkesës nuk e ka tërhequr kërkesën.

h. Kërkesa nr. 23500

113. Kërkesa nr. 23500 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar nga Paraqitësi i kërkesës në vitin 1998 dhe paraqiti një kontratë blerje të shkruar me dorë të lidhur ndërmjet tij dhe paraqitësit të kërkesës dhe një vërtetim për kështin e dytë të çmimit të blerjes. Sekretaria Ekzekutiv kontaktoi paraqitësin e kërkesës dhe djali konfirmoi se Paraqitësi i kërkesës e kishte shitur pronën në vitin 1998.

i. Kërkesat nr. 28806 dhe 28815

114. Kërkesa nr. 28806 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të saj. Kërkesa nr. 28815 është depozituar për të njëjtën pronë nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore (PK2). Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, që e tregojnë Komunën e Rahovecit si bartësin e së drejtës pronësore dhe Drejtorinë për Arsim në Rahovec si shfrytëzuese të pronës së kërkuar. Komuna ka ndërtuar një shkollë në pronën e kërkuar. Kur iu kërkua nga Sekretaria Ekzekutive për të paraqitur dokumentacionin në mbështetje të kërkesave të tyre, paraqitësi i kërkesës u përgjigj se atij i ishte dhënë leja për shfrytëzimin e pronës së kërkuar nga Komuna e Rahovecit, por nuk kishte asnjë dokument për të dëshmuar pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

115. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë të drejtën pronësore apo të shfrytëzimit për pronën e kërkuar para ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

j. Kërkesa nr. 28866

116. Kërkesa nr. 28866 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar dhe ka paraqitur një kontratë të vërtetuar blerje nr. 3757/07 të datës 26 qershor 2007, e cila tregon se ai e ka blerë pronën e kërkuar nga Bali Mekaj, dhe një tjetër kontratë blerje nr. 2936/9 të datës 21 maj 2007, që tregon se Bali Mekaj e kishte e blerë atë nga Petar Rakocevic, nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar, Muhamet Toska i cili është babai i Paraqitësit të kërkesës. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi disa herë Paraqitësin e kërkesës duke i kërkuar atij të paraqesë prova për të mbështetur kërkesën e tij. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive më 9 mars 2010, Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur dhe ai ra dakord të tërheqë kërkesën, por ka dështuar ta bëjë këtë.

117. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë të drejtën pronësore apo posedimin për pronën e kërkuar para ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

k. Kërkesa nr. 28994

118. Kërkesa nr. 28994 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse pretendoi se babai i tij e kishte blerë pronën e kërkuar nga babai i paraqitësit të kërkesës në vitin 1991/1992 dhe paraqiti një kontratë informale të pavërtetuar të blerjes. Ai pretendon se familja e tij ka qenë në posedim të vazhdueshëm të pronës së kërkuar që nga viti 1991. Paraqitësi i kërkesës pranoi se babai i tij e ka shitur pronën e kërkuar në vitin 1991.

119. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se është jo kontestues fakti që paraqitësi i kërkesës nuk ka pasur të drejtën pronësore apo posedimin për pronën e kërkuar para ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

l. Kërkesa nr. 33202

120. Kërkesa nr. 33202 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht djali i mbajtësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse paraqiti fletën poseduese nr. 150 që e tregon pronën e kërkuar në emër të tij në vitin 2001, e përditësuar në bazë të një vendimi trashëgimie, sipas të cilit ai ka trashëguar pronën e kërkuar nga babai i tij, i cili kishte vdekur në vitin 1995. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, Paraqitësi i kërkesës shpjegoi se ai do të paraqiste informacion shtesë. Megjithatë, deri tani, Paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi në mbështetje të kërkesës së tij.

121. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë të drejtën pronësore apo posedimin për pronën e kërkuar para ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

m. Kërkesat nr. 41351, 41352, 41353 dhe 41354

122. Kërkesat nr. 41351, 41352, 41353 dhe 41354 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së tij të ndjerë. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese, që e tregon pronën në emër të nënës së tij. Fleta poseduese është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë.

123. Pala përgjegjëse pretendon se ai dhe vëllai i tij i kanë blerë pronat e kërkuara nga nëna e paraqitësit të kërkesës në vitin 1986, dhe se ata i ka shfrytëzuar ato vazhdimisht që nga ajo kohë. Pala përgjegjëse pohon se nuk është bërë kontratë me shkrim për blerjen midis palëve, por se ai ia ka paguar çmimin e blerjes për të cilin kanë rënë dakord, nënës të paraqitësit të kërkesës në llogarinë e saj bankare. Më tej Pala përgjegjëse tregoi dëshmitarët që mund të konfirmonin shitjen e pretenduar. Fillimisht Paraqitësi i kërkesës e mohoi se nëna e tij e kishte shitur pronën e kërkuar tek pala përgjegjëse.

124. Gjatë seancës së 27-të më 29 shkurt 2012, Komisioni ka urdhëruar që të mbahet seancë dëgjimore për këtë rast nga njëri prej anëtarëve të tij në pajtim me nenin 5.4 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me ligjin nr. 03/L-079. Të dyja palët dhe dëshmitarët e palës përgjegjëse u ftuan të marrin pjesë në seancë dëgjimore më 29 mars 2012 në ambientet e AKP-së në Prishtinë. Pala përgjegjëse, përfaqësuesi i autorizuar i tij Nexhat Beqiri dhe dy dëshmitarë të caktuar nga pala përgjegjëse, Sheremet Curri dhe Imer Mustafa, morën pjesë në seancë. Pala përgjegjëse deklaroi se ai dhe vëllai i tij Hamdi Makiqi i kanë blerë pronat e kërkuara nga nëna e paraqitësit të kërkesës, tani e ndjera Darinka Radec, në vitin 1985 me çmimin e blerjes prej 150 milion dinarë. Ai më tej pohoi se ata kanë pasur posedimin e pronës së qysh nga ajo kohë dhe e kanë kultivuar tokën. Pala përgjegjëse pretendon se ai dhe vëllai i tij kanë paguar çmimin e blerjes në dy kështe, pagesa fillestare prej 20 milion dinarë i është bërë personalisht shitësit Radec Darinka, dhe pjesa tjetër i është paguar djalit të saj Momcilo përmes llogarisë bankare në Jugobanka. Megjithatë, pala përgjegjëse sqaroi se pylli, i cili është subjekt i kërkesës nr. 41350 e depozituar nga i njëjti paraqitësi i kërkesës, nuk ishte pjesë e transaksionit pronësor në mes palës përgjegjëse dhe vëllait i tij dhe nënës të paraqitësit të kërkesës. Komisioni vëren se kërkesa nr. 41350 është vendosur me vendim të Komisionit KPCC/D/A/148/2012.

125. Pasi paraqitësi i kërkesës nuk pati mundësi të marrë pjesë në seancën e mbajtur në Prishtinë më 29 mars 2012, më 3 prill 2012, Paraqitësi e kërkesës u mor në pyetje në ambientet e AKP-së në Mitrovicë. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai është pronar i parcelës së kërkuar në kërkesën nr. 41350, pyll në fshatin Resnik siç dëshmohet nga fleta poseduese. Ai deklaroi se nuk është i interesuar në ndjekjen e kërkesave në lidhje me pronat e tjera, por se nëna e tij nuk e ka shitur pyllin.

126. Bazuar në dëshmitë para tij, duke përfshirë dëshmitë e ofruara në seancën dëgjimore Komisioni konstaton se nëna e Paraqitësit të kërkesës si bartëse e së drejtës pronësore në atë kohë, i ka shitur pronat e kërkuara palës përgjegjëse dhe vëllait të tij, me përjashtim të pronës së kërkuar në kërkesën nr. 41350. Rrjedhimisht kërkesat e bëra në kërkesat nr. 41351, 41352, 41353 dhe 41354 duhet të refuzohen pasi paraqitësi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë se drejtën pronësore ose të drejta të tjera për pronat e kërkuara menjëherë para ose gjatë konfliktit të 1998-99.

n. Kërkesa nr. 44105

127. Kërkesa nr. 44105 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht e bija e mbajtësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar nga bartësi i së drejtës pronësore dhe ka dorëzuar një kontratë të pavërtetuar të blerjes të datës 1 mars 1987. Gjatë përpunimit të kërkesës, paraqitësi i kërkesës paraqiti një vendim trashëgimie, me anë të të cilit ajo trashëgoi 1/3 e pjesës ideale të pronës së kërkuar nga babai i saj. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës dhe ajo konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur para konfliktit në vitin 1987. Megjithatë, ajo nuk e tërhoqi kërkesën.

128. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë të drejtën pronësore apo posedimin për pronën e kërkuar para ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

o. Kërkesa nr. 44434

129. Kërkesa nr. 44434 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar nga Zeqir Ademi, i cili e ka blerë pronën e kërkuar nga familja Kovaçeviq më 23 tetor 1993 dhe ka nënshkruar kontratë me shkrim dore në prani të dy dëshmitarëve e cila asnjëherë nuk u vërtetua. Pala përgjegjëse ka paraqitur kontratën e blerjes si dhe një faturë pagese të datës 25 dhjetor 1993. Kur u ballafaqua me pretendimet e palës përgjegjëse nga Sekretaria Ekzekutive, Paraqitësi i kërkesës pranoi se prona e kërkuar është shitur në vitin 1993 dhe pse ai ra dakord të tërhiqte kërkesën, ai ka dështuar ta bëjë këtë.

130. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë të drejtën pronësore apo posedimin për pronën e kërkuar para ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

p. Kërkesa nr. 44504

131. Kërkesa nr. 44504 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar nga halla/tezja e paraqitësit të kërkesës dhe ka paraqitur një kontratë të vërtetuar të blerjes nr. 9905/03 datë 28 maj 2003 dhe fletën poseduese nr 4898, të përditësuar sipas kontratës së blerjes. Paraqitësi i kërkesës paraqiti dy deklarata me shkrim të datës 11 gusht 2011 dhe 29 shtator 2011, ku ajo pranon shitjen e pronës së kërkuar dhe se ajo kishte synuar të kërkonte për një parcelë tjetër.

132. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë të drejtën pronësore apo posedimin për pronën e kërkuar para ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

q. Kërkesat nr. 44994 dhe 92484

133. Kërkesat nr. 44994 dhe 92484 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht vajza e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një vendim trashëgimie P. Nr. 868/07 të datës 20 gusht 2007, me të cilin ajo ka trashëguar pronat e kërkuara së bashku me dy bashkëpronarë të tjerë. Pala përgjegjëse pretendon se i ka blerë

pronat e kërkuara në vitin 1987 nga Arsa dhe Svetozar Garic në prani të dy dëshmitarëve dhe ka marrë në posedim pronat e kërkuara. Megjithatë, për shkak të barrierave administrative në atë kohë, pikërisht Ligjit të Përkohshëm të Kuvendit të Kosovës për Transferimin e Pronës së Paluajtshme midis Kombësive të ndryshme, që kërkonte miratimin nga Bashkësia Komunale për transferimin e pronës së paluajtshme, pala përgjegjëse nuk ka mundur të regjistrojë pronat e kërkuara në emër të tij. Më pas, Gjykata Komunale në Podujevë i njohu palës përgjegjëse të drejtën pronësore për pronat e kërkuara me vendimin nr. 37/07 të datës 16 mars 2007, sipas të cilit është përditësuar kadastra. Vendimi i Gjykatës Komunale për trashëgiminë P. Nr. 868/07 e datës 20 gusht 2007, ishte lëshuar pa qenë ne dijeni të shitjes së pronave të kërkuara tek pala përgjegjëse.

134. Komisioni konsideron se, në këto rrethana, ai nuk mund të mbështetet në vendimin e trashëgimisë të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës dhe arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë të drejtën pronësore apo posedimin për pronën e kërkuar para ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

r. Kërkesa nr. 91779

135. Kërkesa nr. 91779 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht vjehrrës së saj. Paraqitësi i kërkesës paraqiti autorizimin e lëshuar nga burri i saj i cili e autorizon atë për të vepruar në emër të tij.

136. Pala përgjegjëse pretendon se babai i tij e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 1997 dhe ata kanë qenë në posedim të vazhdueshëm të pronës së kërkuar që nga shitja e saj. Më pas, Paraqitësi i kërkesës e konfirmoi shitjen dhe sqaroi se asnjë kontratë blerje nuk ishte lidhur. Ajo nuk e tërhoqi kërkesën.

137. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë të drejtën pronësore apo posedimin për pronën e kërkuar para ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

III Kërkesa jokontestuese

a. Kërkesat nr. 22199, 22200, 22201, 22203, 22205, 22206, 22207 dhe 22208

138. Kërkesat nr. 22199, 22200, 22201, 22203, 22205, 22206, 22207 dhe 22208 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pretendon se pronat e kërkuara në kërkesën nr. 22199, 22200 dhe 22201 i ka blerë nga Milica Gogic, por ata nuk kanë lidhur kontratë blerje ose nuk i kanë bërë ndryshimet në regjistrat kadastralë. Ai paraqiti fletën poseduese nr. 273, që i tregon pronat e kërkuara në kërkesat e mësipërme në emër të Milica Gogic, i cili e ka trashëguar pronën në përputhje me një vendim të trashëgimie nr. O.br. 12/79. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një deklaratë nga fëmijët e tij të datës 30 gusht 2008, ku deklaroi se paraqitësi i kërkesës i kishte blerë pronat e kërkuara nga Milica Gogic rreth 20 vjet më parë dhe i ishte paguar çmimi i plotë i blerjes dhe se familja e tij kishte shfrytëzuar pronën deri në 14 qershor 1999. Sekretaria Ekzekutive e ka kontaktuar disa herë Paraqitësin e kërkesës, duke i kërkuar atij të paraqesë dokumentacionin shtesë, për të cilin ai ra dakord për të bërë. Ai u pajtua që të paraqesë një deklaratë nga Milica Gogic apo djemtë e Milicia Gogic pasi siç pretendohet, pasi dokumentet origjinale ishin djegur bashkë me shtëpinë.

139. Paraqitësi i kërkesës pretendon se pronat e kërkuara në kërkesën nr. 22203, 22205 dhe 22206 janë shitur nga Stana dhe Milorad Dasic tek Cano Brahimi, i cili pastaj i ka shkëmbyer këto prona me Paraqitësin e kërkesës. Megjithatë, asnjë marrëveshje formale nuk është lidhur ose asnjë ndryshim nuk është bërë në kadastër. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* fletën poseduese nr. 20, e cila i tregon pronat e kërkuara në emër të Stana Dasic. Sekretaria Ekzekutive ka kontaktuar disa herë Paraqitësin e kërkesës, duke i kërkuar të paraqesë dokumentacionin shtesë në mbështetje të kërkesave të tij pronësore për këto prona. Megjithatë, ai dështoi të paraqesë dokumentacion të tillë.

140. Paraqitësi i kërkesës pretendon se i ka blerë pronat e kërkuara në kërkesat nr. 22207 dhe 22208 rreth 50 vjet më parë nga Sultana Maksimovic, Milic Popovic dhe Tomash Popovic. Megjithatë, asnjë marrëveshje formale nuk është lidhur ose asnjë ndryshim nuk është bërë në kadastër. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* fletën poseduese nr. 233, që i tregon pronat e kërkuara në emrat Sultana Maksimovic, Milic Popovic dhe Tomash Popovic. Sekretaria Ekzekutive ka kontaktuar disa herë Paraqitësin e kërkesës, duke i kërkuar atij të paraqesë dokumentacionin shtesë në mbështetje të kërkesave të pronësisë për këto prona. Megjithatë, ai dështoi të paraqesë dokumentacion në mbështetje të kërkesave të pronësitë të tillë.

141. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën e pronësisë ose posedimit për pronat e kërkuara përpara ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

b. Kërkesat nr. 22745, 22746, 22747, 22748 dhe 22749

142. Kërkesat nr. 22745, 22746, 22747, 22748 dhe 22749 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht, vjehrrit të saj. Paraqitësi i kërkesës paraqiti autorizimin e lëshuar nga djali i saj të datës 17 korrik 2008, me të cilin e autorizon atë për ta përfaqësuar si nipin e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Më tej, ajo ofroi një fletë të vjetër poseduese nr. 54 të vitit 1966 që i tregon pronat në emër të vjehrrit të saj.

143. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* fletën poseduese nr. 1 në lidhje me pronat e kërkuara, të regjistruara në emër të Ndërmarrjes Publike të Ujësjiellësit K.R.U Hidrosistemi Radoniq Sh.a. Zyrtari kadastral i konfirmoi Sekretarisë Ekzekutive se Kadastra është përditësuar në vitin 2007, ku është ndryshuar emri i Ndërmarrjes Publike të Ujësjiellësit nga një kompani Holding në Ndërmarrjen Publike të Ujësjiellësit K.R.U Hidrosistemi Radoniq Sh.a në bazë të një akti transferimi për të drejtën e bartësit të së drejtës pronësore për pronat e paluajtshme nr. 1869 datë 27 korrik 2007. Paraqitësi i kërkesës është kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive dhe u pyet për të konfirmuar datën kur familja ka humbur posedimin e pronave të kërkuara. Paraqitësi i kërkesës u përgjigj se ajo nuk e di dhe se nuk ka asnjë anëtar të familjes gjallë që ka poseduar pronën për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje. Paraqitësi i kërkesës më tej pohoi se ajo nuk di që ndonjë anëtar të familjes të ketë jetuar në të apo ta ketë vizituar pronën para konfliktit. Paraqitësi i kërkesës tregoi gjithashtu se nuk ishte e interesuar për ndjekjen e kërkesës më tej, por nuk e tërhoqi kërkesën. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës dështoi gjithashtu të paraqitë dëshmi të marrëdhënies familjare midis mbajtësit të së drejtës pronësore dhe djalit të saj.

144. Ndërmarrja Publike e Ujësjiellësit K.R.U Hidrosistemi Radoniq Sh.a u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive. Një përfaqësues i ndërmarrjes shpjegoi se pronat e kërkuara

ishin shpronësuar nga Hidrosistemi Radoniqi i asaj kohe në vitin 1978 me vendim të Sekretariat për Ekonomi dhe Financa të Komunës së Gjakovës.

145. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën e pronësisë ose posedimit për pronat e kërkuara përpara ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

c. Kërkesat nr. 26789 dhe 26792

146. Kërkesat nr. 26789 dhe 26792 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një fletë të vjetër poseduese nr. 173 të vitit 1938, që i tregon pronat e kërkuara në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 72 dhe 100, i cila e tregon pronën e kërkuar në kërkesën nr. 26789 në emër të Z. Milorad Pejcinovic dhe pronën e kërkuar në kërkesën nr. 26792 në emër të Z. Arif Kabashi. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës dhe e informoi atë për sa më sipër. Më pas, Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se prona e kërkuar është shitur para konfliktit të vitit 1998-99.

d. Kërkesat nr. 28546, 28547, 28548, 28549, 28550 dhe 90952

147. Kërkesat nr. 28546, 28547, 28548, 28549, 28550 dhe 90952 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një vendim trashëgimie O.br. 12/2, datë 30 prill 2003, të lëshuar nga një gjykatë paralele në Istog, në bazë të të cilit ajo ka trashëguar pronat e kërkuara nga vjehrra. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* fletën poseduese nr 130, që i tregon pronat e kërkuara në emër vjehrrës së paraqitësit të kërkesës. Paraqitësi i kërkesës u kontaktua disa herë nga Sekretaria Ekzekutive dhe u informua për pjekjet për verifikim nga Sekretaria Ekzekutive. Paraqitësit të kërkesës iu kërkuar të dorëzojë një vendim të vlefshëm trashëgimie ose ndonjë dokumentacion shtesë për të dëshmuar pronësinë e saj për pronën e kërkuar ose autorizim nga trashëgimtarët e vjehrrës, pasi ajo nuk bie në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare. Paraqitësi i kërkesës tregoi se do të inicionte procedurën e trashëgimie në një gjykatë të rregullt dhe do të paraqiste vendim të vlefshëm trashëgimie dhe autorizim nga trashëgimtarët e vjehrrës, megjithatë ajo ka dështuar ta bëjë këtë.

148. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshminë e duhur të pronësisë ose për të drejta të tjera pronësore dhe kërkesat duhet të refuzohen.

e. Kërkesat nr. 33300 dhe 33306

149. Kërkesat nr. 33300 dhe 33306 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij, për të cilin ai pretendon se është person i zhdukur. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 62 që i tregon pronat e kërkuara në emër të babait të tij. Ai paraqiti gjithashtu fletën poseduese nr. 60 dhe një deklaratë ku kërkon që kërkesat të përpunohen në bazë të fletës të fundit poseduese; megjithatë kjo fletë poseduese nuk ka të bëjë me pronat e kërkuara. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 182, e cila i tregon pronat e kërkuara në emër të Halit Rrahimit. Sekretaria Ekzekutive e ka kontaktuar paraqitësin e kërkesës dhe e ballafaqoi atë

me këtë informacion. Paraqitësi i kërkesës më pas konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur para konfliktit të vitit 1998-99.

150. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë të drejtën pronësore apo posedimin për pronën e kërkuar para ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

f. Kërkesa nr. 42364

151. Kërkesa nr. 42364 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një fletë poseduese të vjetër nr. 173 të vitit 1939, e shënuar në emër të bartësit të së drejtës pronësore, në mbështetje të kërkesës së tij. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* fletën poseduese nr. 555 e regjistruar në emër të Ragip Xhukajt, e përditësuar në vitin 1998, në bazë të një kontrate blerje P. Br. 346/97 më 12 dhjetor 1997 në Gjykatën Komunale në Istog. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive dhe u informua sa më sipër, Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur para konfliktit të 1998-99.

152. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë të drejtën pronësore apo posedimin për pronën e kërkuar para ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

g. Kërkesat nr. 51004, 51005, 51006, 51008, 51009, 51010 dhe 51011

153. Kërkesat nr. 51004, 51005, 51006, 51008, 51009, 51010 dhe 51011 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti dokumente të ndryshme në mbështetje të kërkesave të tij; megjithatë, ka pasur një mospërputhje në mbiemrin e mbajtësit të drejtës pronësore në dokumentet e paraqitura. Dokumentet e identifikimit tregojnë atë si Ali Memet Maka, ndërsa dokumentet e paraqitura në mbështetje të kërkesës të pronësisë, përkatësisht kontrata e blerjes nr. 786/80, datë 29 prill 1980 dhe Certifikata për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 12 e tregojnë Ali Mehmet Berishën si bartësin i së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës në disa raste ku i kërkoi të sqaronte mospërputhjen. Më 23 shkurt 2010, ai u kontaktua për të sqaruar mospërputhjen e emrit dhe të paraqiste një dokument të vërtetuar nga zyra e gjendjes civile ku të shpjegohej mospërputhja e emrit ose një flete poseduese të korrigjuar me emrin aktual të tij. Më 14 janar 2011, paraqitësi i kërkesës u kontaktua përsëri dhe iu kërkua të paraqiste një dokument të lëshuar nga një gjykatë kompetente apo zyre e gjendjes civile që provon se Ali Maka dhe Ali Mehmet Berisha është i njëjti person. Në të dyja rastet paraqitësit të kërkesës iu dha një afat për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar, por ai dështoi të paraqesë dokumentacionin e tillë.

154. Më 20 dhjetor 2011, Paraqitësi i kërkesës u kontaktua sërish dhe iu kërkua të dorëzojë dokumentet për sqarimin e mospërputhjes së emrit. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ka dy mbiemra dhe dy dokumente identifikimi, por dështoi të vërtetojë pretendimet e tij ose të ofrojë dëshmi për to. Paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për këtë qëllim.

155. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën pronësore ose të posedimit për pronat e kërkuara të kërkuara përpara ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

h. Kërkesat nr. 51121, 51123, 51124 dhe 51125

156. Kërkesat nr 51121, 51123, 51124 dhe 51125 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një kopje të padisë të depozituar para Gjykatës Komunale në Pejë, datë 31 maj 2004 ku kërkohet kompensim për dëmet e shkaktuara në pronën e tij për shkak të konfliktit, prona përcaktohet ashtu si shënohet në fletën poseduese nr. 211, domethënë parcela nr. 22 / 1, 216/6 (numri i saktë është 216/2 pasi nuk ka parcelë me nr. 216/6 në fletën poseduese; kjo konfirmohet nga paraqitësi i kërkesës), 216/7, 216/8, 219/1, 225/5 dhe 260/1. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* fletën poseduese nr. 211, e regjistruar në emër të Paraqitësit të kërkesës si pronar i pjesës ideale prej ¼ të pronave të kërkuara, përveç parcelës së tokës nr. 22/1, e cila është regjistruar në emër të një palë tjetër.

157. Paraqitësi i kërkesës ka ofruar vetëm kulturën dhe sipërfaqen e pronave të kërkuara në formularin e pranimit të kërkesave, të cilat nuk përputhen me sipërfaqen e parcelave të tokës të fletës poseduese nr. 211 ose padisë të vitit 2004. Paraqitësi i kërkesës u kontaktua disa herë nga Sekretaria Ekzekutiv për të qartësuar identitetin e parcelave të tokës të kërkuar nga paraqitësi i kërkesës në secilën kërkesë dhe nëse këto kërkesa përfshinin pronat që nuk përfshihen në padi. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se do të vizitonte zyrën e AKP-së me qëllim që të sqaronte situatën në mënyrë që bëhej identifikimi i pronës së kërkuar në secilën kërkesë, megjithatë ai dështoi të ofrojë këtë sqarim.

158. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën e pronësisë ose posedimit të pronave të kërkuara përpara ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.

i. Kërkesat nr. 54794, 54798, 54800, 54803, 54806, 54807, 54809 dhe 54811.

159. Kërkesat nr. 54794, 54798, 54800, 54803, 54806, 54807, 54809 dhe 54811 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës pretendoi se babai i tij i ka blerë pronat e kërkuara nga Bajram Nikqi në vitin 1958 dhe se kontrata e blerjes ishte nënshkruar për këtë qëllim në vitin 1986 dhe regjistruar me nr. 6/86. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 131 që e tregon Bajram Nikqin si pronar të pronave të kërkuara.

160. Sekretaria Ekzekutive e ka kontaktuar disa herë Paraqitësin e kërkesës duke e ftuar atë për të dorëzuar dokumentacionin për të dëshmuar të drejtën pronësore të mbajtësit të së drejtës pronësore për pronat e kërkuara. Edhe pse paraqitësi i kërkesës ra dakord që të paraqiste kontratën e blerjes ose vendimin e gjykatës, ai nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion shtesë.

161. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konsideron se Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën pronësore apo të posedimit për pronat e kërkuara përpara ose në kohën e konfliktit në vitet 1998-1999.


D. Kërkesa për kompensim

162. Në kërkesat nr. 06248, 06250, 10144, 18345, 19268, 19269, 19270, 19271, 20185, 22047, 22048, 22050, 22483, 22745, 22746, 22747, 22748, 22749, 23029, 23030, 23313, 23500, 23754, 26789, 26792, 31501, 31502, 31503, 31504, 31505, 31510, 31513, 31544, 34140, 35303, 35778, 47588, 47603, 47604, 47605, 49642, 49643, 49644, 54794, 54798, 54800, 54803, 54806, 54807, 54809, 54811, 54982, 54984, 54989, 54990, 90019, 90155, 91604 dhe 90162, paraqitësit e kërkesave kërkojnë gjithashtu, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin fizik ose humbjen e shfrytëzimit për pronën e kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla. Rrjedhimisht këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

E. Vërejtje përmbledhëse

163. Vendimi dhe urdhri i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

164. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.


Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA13269	KPA17662	KPA28982	KPA28983	KPA28984	KPA28985	KPA28986
KPA29145	KPA51021	KPA51023	KPA51024	KPA18345	KPA18346	KPA22485
KPA22486	KPA35303	KPA38812	KPA00264	KPA25055	KPA36999	KPA37427
KPA51521	KPA92290	KPA92291	KPA92292	KPA23754	KPA26474	KPA33210
KPA47318	KPA47588	KPA21062	KPA21066	KPA21068	KPA21069	KPA21070
KPA21071	KPA28525	KPA28526	KPA90374	KPA90381	KPA90386	KPA90387
KPA23029	KPA23030	KPA34140	KPA53652	KPA06282	KPA10014	KPA10310
KPA10477	KPA26113	KPA26116	KPA49642	KPA49643	KPA49644	KPA00078
KPA20204	KPA20205	KPA20207	KPA30668	KPA36820	KPA49412	

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA11665	KPA11666	KPA11673	KPA17905	KPA28994	KPA91779	KPA13694
KPA13695	KPA13697	KPA20185	KPA23500	KPA44105	KPA44994	KPA92484
KPA22266	KPA33202	KPA08677	KPA08681	KPA08683	KPA08684	KPA08685
KPA28806	KPA28815	KPA28866	KPA92487	KPA92488	KPA06248	KPA06250
KPA44434	KPA44504	KPA41351	KPA41352	KPA41353	KPA41354	

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA10144	KPA22047	KPA22048	KPA22050	KPA35778	KPA50327	KPA50328
KPA90019	KPA90155	KPA90162	KPA91801	KPA91802	KPA11052	KPA23313
KPA26121	KPA30776	KPA30778	KPA30779	KPA30782	KPA30783	KPA30786
KPA30787	KPA19268	KPA19269	KPA19270	KPA19271	KPA44613	KPA45258
KPA54982	KPA54984	KPA54989	KPA54990	KPA44819	KPA44820	KPA44824
KPA44827	KPA44829	KPA44831	KPA44833	KPA44837	KPA44838	KPA44842
KPA44844	KPA44846	KPA47604	KPA47605	KPA47786	KPA47194	KPA47195
KPA47196	KPA47197	KPA47198	KPA47199	KPA47200	KPA47201	KPA47202
KPA47204	KPA47205	KPA47206	KPA51705	KPA51706	KPA51710	KPA51711
KPA51713	KPA51714	KPA51715	KPA22483	KPA31501	KPA31502	KPA31505
KPA31544	KPA41154	KPA41159	KPA47603	KPA47107	KPA47108	KPA47110
KPA47111	KPA47112	KPA47113	KPA31503	KPA31504	KPA31510	KPA31513
KPA91604	KPA50540	KPA50552	KPA50553	KPA50554	KPA50555	KPA50556
KPA50557						

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part D/Pjesa D/Deo D

KPA28546	KPA28547	KPA28548	KPA28549	KPA28550	KPA51004	KPA51005
KPA51006	KPA51008	KPA51009	KPA51010	KPA51011	KPA90952	KPA54794
KPA54798	KPA54800	KPA54803	KPA54806	KPA54807	KPA54809	KPA54811
KPA22199	KPA22200	KPA22201	KPA22203	KPA22205	KPA22206	KPA22207
KPA22208	KPA42364	KPA22745	KPA22746	KPA22747	KPA22748	KPA22749
KPA26789	KPA26792	KPA33300	KPA33306	KPA51121	KPA51123	KPA51124
KPA51125						